



RAPORTI VJETOR

**I VEPRIMTARISË MËSIMORE,
KËRKIMORE-SHKENCORE DHE
FINANCIAR PËR VITIN 2018-2019**

Tiranë, shkurt 2020

Përmbajtja

I. HYRJE	3
II. PËRMBLEDHJE	5
III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UMT ...	8
3.1 Organizimi i UMT-së	8
3.2 Funkcioni i organeve kolegjiale/drejtuese.....	9
3.3 Njësitë administrative ndihmës akademike (rektorat/dekanat) dhe komisionet ad- hoc	11
3.4 Aktiviteti i njësive kryesore	12
3.5 Sekretaritet mësimor në njësitë kryesore	17
IV. VEPRIMTARIA AKADEMIKE.....	18
4.1 Programet e studimit	18
4.2 Procesi mësimor, mësimdhënia dhe vlerësimi.....	20
V. PERSONELI AKADEMIK DHE AKTIVITETET E REALIZUARA.....	24
5.1 Personeli akademik.....	24
IV. KËRKIMI SHKENCOR	28
6.1 Fakulteti i Mjekësisë	28
6.2 Fakulteti i Mjekësisë Dentare	28
6.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.....	28
6.4 Aktiviteti kërkimor-shkencor 2018-2019.....	28
6.5 Bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel universiteti	28
6.6 Shkëmbimet në kuadër të Programit Erasmus+	31
6.7 Anëtarësimi i UMT-së në rrjete ndërkombëtare	32
6.8 Aktivitete të edukimit të vazhdim, të akredituara nga Qendra e Zhvillimit Profesional në UMT.....	32
VII. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA NË FUNKSION TË AKTIVITETIT AKADEMIK	34
7.1 Infrastruktura, logjistika dhe shërbimet	34
VIII. STUDENTËT	36
8.1 Regjistrimet në programet e studimit për vitin akademik 2018-2019.....	36
8.2 Mbështetja ndaj studentëve	38
IX. REFERENCA	39
X. ANALIZA FINANCIARE 2019	40

I. HYRJE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, e ndryshuar, Planin e zhvillimit strategjik të UMT- së, si dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor...”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 21.10.2019, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, paraqet Raportin vjetor të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore për vitin akademik 2018-2019 dhe financiar për vitin (kalendarik) 2019 në nivel universiteti, në kuadër të informimit dhe transparencës për veprimtarinë e tij.

Kjo analizë duhej të përfundonte në muajin dhjetor (sipas udhëzimit nr.5 të MASR, i ndryshuar) po për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti dt. 26 nëntor 2019, procesi mësimor dhe aktivitetet e tjera të UMT u shtynë deri në datën 06.01.2020. Për këtë arsye, analizat vjetore në nivel njësie kryesore u zhvilluan në muajin janar 2020, ndërsa analiza vjetore në nivel universiteti u zhvillua në muajin shkurt 2020.

Misioni i Universiteti të Mjekësisë, Tiranë është ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera në fushën e shkencave mjekësore. UMT ofron programe në tre ciklet e studimit, në përputhje me standardet me të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e shëndetësisë, me qëllim që të ofrojnë dhe praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, të synojnë në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha.

Në zbatim të misionit të universitetit dhe kuadrit ligjor në fuqi, ky raport synon të paraqesë aspektet kryesore të aktivitetit akademik në UMT, duke vënë theksin edhe te problematika të evidentuara dhe të adresuara për zgjidhje, me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë.

Ky raport bazohet më raportet analitike të njësive kryesore (fakultetet) të UMT-së, si dhe të strukturave të tjera të UMT-së, Konkretisht, ky raport është bazuar në:

- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor dhe financiar të Fakultetit të Mjekësisë;
- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor dhe financiar të Fakultetit të Mjekësisë Dentare;
- Raportin vjetor mësimor, kërkimor-shkencor dhe financiar të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike;
- Raporte informuese e analitike të organeve kolegjiale të UMT-së (Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit);
- Raporte informuese e analitike të komisioneve në nivel universiteti (Këshilli i Botimeve, Këshilli i Etikës, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë);
- Të dhënat statistikore të marra nga raporte vjetore të fakulteteve që paraqesin regjistrimet në programet e studimit, rezultatet e studentëve dhe kalueshmërinë, transferimet, diplomimet etj.
- Relacionet dhe treguesit e PBA të miratuara për vitet 2018-2020 dhe PBA 2019-2021.
- Analizat financiare dhe ekonomike të vitit 2019.
- Analizat ekonomike dhe financiare të Njësive Kryesore të UMT-së (FM, FSHMT dhe FMD)
- Në sistemin e evidencave të plotësuar dhe të rakorduar me sistemin e thesarit.
- Materiale, dokumente dhe informacione, të hartuara në kuadër të aktiviteteve të ndryshme të realizuara në nivel fakulteti apo të zhvilluara nga personeli akademik i fakulteteve të UMT-së etj.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur aktivitetin në tërësi të universitetit, ndërsa Raportet vjetore në nivel njësie kryesore, si dhe aktivitetet e detajuara, janë publikuar në faqet zyrtare të fakulteteve dhe të universitetit.

Një kopje e këtij raporti dërgohet në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe një kopje publikohet në versionin elektronik në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

II. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor është një pasqyrë e aktivitetit akademik (2018-2019) dhe aktivitetit financiar (2019) të zhvilluar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Raporti vjetor paraqet informacione, gjetje, konstatime dhe vlerësime për të gjitha aspektet e veprimtarisë që universiteti dhe fakultetet e tij zhvillojnë.

Raporti pasqyron në formë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje për:

- funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse (organe kolegjiale, komisione të përhershme) në lidhje me aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike dhe financiare të UMT-së dhe të fakulteteve;
- procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, njohuritë dhe kompetencat në nivel njësie kryesore;
- kërkimin shkencor në UMT dhe projektet ku personeli i UMT-së merr pjesë si palë aktive. Raporti adreson aspekte të politikave të kërkimit shkencor, të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga departamentet, si dhe të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor;
- programet e studimit që ofron UMT-ja, duke paraqitur programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, riorganizimin e tyre dhe përditësimin e syllabuseve, si dhe ofrimin e edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetit;
- parashikimin për angazhimin e personelit akademik dhe ngarkesën mësimore;
- gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet gjatë vitit akademik 2018- 2019;
- përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen (si profesion i rregulluar);
- numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programet e studimit që ofron UMT-ja, mbështetjen për studentët (bursa apo përjashtim/reduktimi i tarifave të shkollimit), pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre, cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi;
- mobilitetin e personelit akademik të financuar nga fakulteti/UMT-ja apo të realizuar në kuadër të projekteve;
- infrastrukturën, ku përfshihen mjediset didaktike dhe kërkimore, politike në shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numrin e teksteve dhe infrastrukturën informatike në funksion të mësimin, përmirësimit dhe plotësimit, sipas standardeve shtetërore të cilësisë.
- plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukture, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin,
- planin buxhetor Universitetit (1 vjeçar) dhe realizimin faktik të tij sipas zërave të buxhetit, pagesat për pagat, sigurimeve shoqërore e shëndetësore,

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga njësitë kryesore të UMT-së, nga sektorët

përkatës të Rektoratit, nga sekretariatet teknike të organeve përkatëse, si dhe në bazë të raporteve dhe analizave të kryera nga UMT për institucione të tjera, rezulton se:

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, organizohet dhe menaxhohet në zbatim të Statutit dhe Rregullores së tij. Në mbledhjet e organeve kolegjiale dhe drejtuese ndiqen procedura dhe protokolle të përcaktuara. UMT-ja, në plotësim të kërkesave të ligjit nr. 80/2015 dhe të statutit të ri në përputhje me këtë ligj, ka si prioritet fuqizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, reflektuar kjo dhe në miratimin e një strukture të posaçme për sigurimin e cilësisë.

Nga burimet në dispozicion të UMT, konstatohet se është treguar përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave përkatëse nga strukturat përgjegjëse. Universiteti është në gjendje të tërheqë një gamë të gjerë burimesh dhe mbështetje nga sektori i shëndetësisë dhe të përfitojë, në veçanti, nga afërsia fizike me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe strukturat e tjera spitalore universitare. Kjo ofron një shtrirje burimesh të vazhdueshme dhe të pasura, si për stafin, ashtu edhe për studentët. Megjithatë identifikohet si dobësi mungesa e qasjes dhe mekanizmave financiare të UMT-së për të siguruar të ardhura nga shërbimet cilësore që mund të ofrojë universiteti, me kapacitetet akademike, profesionale dhe infrastrukturore që ka (edukimi në vazhdim, ofrim shërbimi ndaj pacientëve etj.), gjë e cila është identifikuar dhe vitin e kaluar.

Kurrikula që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është e lidhur ngushtësisht me kërkesat e profesionit dhe mbështetet nga një rrjet i fuqishëm mjekësh dhe urdhrash profesionalë. Programet e studimit janë qartësisht të përcaktuara dhe të përshtatshme, kjo në përmbushje të misionit që UMT ka *“...ofrimi i arsimimit gjithëpërfshirës i studentëve, i kualifikimit të tyre, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera në fushën e shkencave mjekësore. UMT ofron programe në tre ciklet e studimit, në përputhje me standardet me të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fushën e shëndetësisë, me qëllim që të ofrojnë dhe praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, të synojnë në parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor në këto fusha”*.

Sërish evidentohet fakti që programet e studimit të ciklit të parë të shkencave mjekësore teknike duhet të kenë një rritje të numrit të orëve në total (krahasuar me programe të ngjashme në nivel evropian). Kjo problematikë është adresuar në MASR dhe vitin e kaluar, për të mundësuar një akt normativ specifik për këto programe studimi.

Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi në UMT, kryhet në përputhje me rregulloren e universitetit dhe rregulloret e fakulteteve të tij. Konstatohet se ekziston një marrëdhënie e fortë me praktikën profesionale, ku pjesa më e madhe e orëve mësimore zhvillohen në bashkëpunim me struktura shëndetësore universitare (QSU) dhe struktura shëndetësore jo universitare. Megjithatë, për shkak dhe të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron UMT-ja, duhet një qasje me efektshmëri në të gjithë universitetin, e shoqëruar kjo me procedurat përkatëse, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm në cilësinë e mësimdhënies, si për stafin e ri, ashtu edhe për atë me përvojë, duke marrë parasysh praktikën më të mira ndërkombëtare. Për sa i përket kërkimit shkencor, UMT-ja duhet të hartojë objektiva konkrete sipas fushave të kërkimit, duke i mbështetur dhe me fondet përkatëse.

Studentët janë të organizuar në këshilla studentorë. Studentët e viteve të larta kanë marrëdhënie të ngushta me stafin akademik, për shkak të organizimit të grupeve me cikle. Studentet mbështeten dhe kanë akses në një gamë të gjerë të aktiviteteve sociale dhe komunitare, por kjo mbështetje mbetet gjithsesi e kufizuar.

Universiteti ka forcuar mbështetjen ndaj studentëve, kjo dhe nga një analizë e kërkesave të detajuara të studentëve gjatë protestës së tyre, dhjetor 2018. Konkretisht mbështetja e karrierës nëpërmjet projekti GRADUA, ku çdo fakultet ka person përgjegjës me kohë të plotë për monitorimin dhe ndjekjen e regjistrimit të studentëve të viteve të fundit, për punësimin e tyre. Promovimi i studentëve të Rrjetit i Ekselencës së Studentëve të UMT-së (NES-UMeD), është një nga mbështetjet që UMT-ja jep për studentët, por që struktura përgjegjëse përkatëse në Rektorat ende nuk ka një plan aktiviteteve konkrete për mbështetjen dhe funksionimin e këtij rrjeti.

Raporti i detajuar sipas aspekteve jepet në vijim të këtij raporti të përmbledhur.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ORGANEVE DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE NË UMT

3.1 Organizimi i UMT-së

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 48, datë 23.01.2013 “Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)”, i ndryshuar. Pas riorganizimit në vitin 2016, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, aktualisht përbëhet nga 3 njësi kryesore (fakultete) si më poshtë:

- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Fakulteti i Mjekësisë, i krijuar në vitin 1957 në varësi të Universitetit Shtetëror të Tiranës, është vazhdim i Institutit të Lartë Mjekësor (hapur për herë të parë si institucion i arsimit të lartë në Shqipëri në shtator të vitit 1952), i cili kishte për mision përgatitjen e mjekëve të përgjithshëm. Ky fakultet, i cili deri më 2013 ofronte programet e studimit në mjekësi të përgjithshme, stomatologji dhe farmaci, u riorganizua në 2 (dy) fakultete:

1. Fakulteti i Mjekësisë, ku ofrohen programet e të tria cikleve të studimit, sipas kartës së Bolonjës, përkatësisht në Mjekësi, Farmaci dhe Shëndet publik;
2. Fakulteti i Mjekësisë Dentare, që ofron ciklin e plotë të studimeve sipas kartës së Bolonjës në fushën e dentistrisë.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është vazhdim i Fakultetit të Infermierisë, i cili me VKM- në nr. 612, datë 21.09.2004, u krijua nga riorganizimi i Shkollës së Lartë të Infermierisë, në varësi të Universitetit të Tiranës. Fillimisht, Fakulteti i Infermierisë ka ofruar vetëm programet e studimit Infermier i Përgjithshëm, Mami, Logopedi, Teknik Laboratori. Nisur nga fakti se Fakulteti i Infermierisë ofronte programe studimi në disa drejtime të shkencave mjekësore, në vitin 2012 ai u bë Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Me themelimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në janar 2013, FSHMT-ja u bë pjesë përbërëse (njësi kryesore e universitetit).

Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UMT-së, të ndryshuar, struktura akademike dhe administrative e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është:

- organet kolegjiale (Senati Akademik, Bordi i Administrimit);
- autoritetet drejtuese;
- organet drejtuese (*Rektorati, ku bën pjesë Rektori, zëvendës rektorët, dekanët e fakulteteve, administratori i UMT-së; dekanatet, ku bën pjesë Dekani, drejtuesit e departamenteve, zëvendës dekanët dhe administratori i fakultetit*);
- Njësitë kryesore (Fakulteti i Mjekësisë, me 17 njësi bazë; Fakulteti i Mjekësisë Dentare, me 3 njësi bazë; Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, me 3 njësi bazë);
- personeli akademik dhe personel ndihmës mësimor.
- struktura ndihmës akademike me karakter administrativ dhe struktura administrative në Rektoratin e UMT-së dhe e Fakulteteve të UMT-së.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, e ushtron veprimtarinë e tij bazuar në:

- legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor (ligji nr. 80/2015, VKM, urdhra dhe udhëzime të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Kodin e Cilësisë për Arsimin e Lartë, si dhe akte të tjera të miratuara e që zbatohen në arsimin e lartë);
- Statutin e UMT-së (*miratuar me Urdhër nr.424, datë 8.8.2019 të ministrit përgjegjës për arsimin* ,
- Rregulloren e UMT-së, e ndryshuar;
- vendime të Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të UMT-së;
- vendime dhe urdhra të Rektorit dhe Administratorit të UMT-së.

3.2 Funksionimi i organeve kolegjiale/drejtuese

Në zbatim të Statutit dhe të Rregullores të UMT, çdo njësi/strukturë, personel akademik, ndihmës akademik, dhe jo akademik është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procedurave, aktiviteteve dhe veprimtarive që zhvillon universiteti për realizimin e objektivave për zhvillimin e procesit mësimor dhe shkencor, si dhe aktiviteteve të tjera.

Në vitin akademik 2018-2019 janë miratuar një sërë aktesh nënligjore në zbatim të ligjit nr. 80/2015, zbatimi i të cilave ka kërkuar angazhimin e organeve kolegjiale dhe drejtuese të universitetit dhe të fakulteteve.

Universiteti ka përfaqësuesit e tij (në nivel fakulteti) në grupet e punës ngritur nga institucione qendrore (ministritë përkatëse) apo në grupet e punës të spitaleve universitare për çështje të caktuara, si dhe në komisionet e licencimit të programeve dhe komisionet e provimit për lejen e ushtrimit të profesioneve të rregulluara.

Lidhur me komisionet e licencimit, evidentohet problematika e ngritur nga përfaqësuesit e UMT-së, për rishikimin e pyetjeve të provimit të licencimit, pasi gjeihen mospërputhje me programet lëndore, të cilat përmirësohen dhe ndryshojnë vit pas viti, në kuadër të rritjes së cilësisë (kryesisht për profesionet e rregulluara të shkencave mjekësore teknike). Problematikë e bërë prezent dhe në raportin vjetor të vitit paraardhës.

Referuar aktivitetit të zhvilluar gjatë vitit akademik, organet kolegjiale dhe autoritetet drejtuese kanë kryer veprimtaritë kryesore si vijon:

Senati Akademik ka ushtruar kompetencat e tij në mbarëvajtjen e veprimtarisë akademike gjatë të gjithë vitit akademik, nëpërmjet vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse (80 VSA), të cilat i janë adresuar njërive përkatëse për zbatim.

SA ka shqyrtuar dhe miratuar, me vendimet përkatëse, kuotat dhe kriteret e pranimit në programet e studimit që ofrojnë njësitë kryesore të UMT-së për vitin akademik përkatës, si dhe propozimin për tarifat e shkollimit për çdo program, marrëveshjet e bashkëpunimit me të tretë (janë lidhur 18 marrëveshje me IAL vendase dhe të huaja); shqyrtuar projekt propozimet për programet e studimit (ndryshime/përmirësime apo riorganizim) propozuar nga njësitë kryesore, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së ofertës akademike të UMT; shqyrtuar plan buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të UMT; ka shqyrtuar çështje specifike (psh. doktoratat në proces të FSHMT) etj

Bordi i Administrimit ka ushtruar kompetencat e veta në mbarëvajtjen e veprimtarisë financiare të UMT-së, nëpërmjet vendimeve të marra (65 vendime), ku një pjesë e mirë e tyre i dedikohet mbështetjes financiare të studentëve, kjo në kuadër të protestës së përgjithshme të

tyre, ku kërkesat për mbështetje financiare ishin të qenësishme. Gjithashtu, BA ka shqyrtuar dhe miratuar tarifat për të gjitha ciklet e studimit, listat për përjashtim nga tarifa për studentët që plotësonin kriteret sipas akteve ligjore e nënligjore përkatëse, buxhetin e institucionit etj. Evidentohet shqetësues fakti i mosplotësimit të strukturave administrative (financiare) në nivel rektorati apo fakulteti.

Bordi i Administrimit e kryen veprimtarinë e tij në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh*".

Rektori/Dekani/Drejtuesi i departamentit (autoritete drejtuese) kanë qenë të angazhuar për mbarëvajtjen e procesit mësimor, monitorimin e regjistrimit të studentëve, menaxhimin e personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesshme, raportimet periodike, si dhe për zgjidhjen e mjaft problematikave të evidentuara gjatë zhvillimit të procesit mësimor, sezoneve të provimeve, praktikave profesionale dhe diplomimit. Si autoritete drejtuese, ato kanë zhvilluar takime me titullarë të institucioneve qendrore shtetërore për zgjidhjen e problematikave të hasura në institucion, si dhe kanë përcjellë projekt-propozime konkrete për të gjitha draft-aktet rregullative e nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin, në kuadër të mirëfunksionimit të institucionit tonë.

Gjithashtu janë realizuar një sërë takimesh në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me të tretë, takime lobimi për universitetin, si dhe takime informuese me studentët, stafin akademik, median apo të interesuar të tjerë, në kuadër të rritjes së transparencës dhe informimit (disa prej aktiviteteve janë paraqitur edhe në faqen zyrtare të internetit të UMT-së dhe në ato të fakulteteve).

Rекторати/dekanatet (organe kolegjiale), në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë shqyrtuar dhe marrë vendime lidhur me strukturën e vitit akademik, komisionet për monitorimin e pranimeve/regjistrimeve të reja, transferimin e studimeve, komisionet për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, etj. Po ashtu janë propozuar dhe miratuar grupe pune të proceseve të organizuara në nivel universiteti, në komisione apo grupe të posaçme.

Referuar Raporteve vjetore të fakulteteve, konkretisht nga analiza e Dekanatit të FSHMT, konstatohet një angazhim i ulët i stafit akademik në kërkim shkencor, në veprimtaritë dhe aktivitete në kuadër të fakultetit, në angazhimin e tyre në hartimin e projekteve etj, si më poshtë:

- Jo i gjithë personelit akademik, është angazhuar në plotësimin e ngarkesës vjetore të të punës (mësimdhënie, kërkim, angazhime administrative dhe kontribute të tjera).
- Angazhimi i stafit për kërkimin shkencor, është i ulët.
- Ka pjesëmarrje të ulët të pjesëmarrjes të stafit akademik në aktivitete kërkimore-shkencore, botime brenda dhe jashtë vendit.
- Angazhimi i personelit akademik në grupe pune, në përgjithësi ka qenë problematike.
- Angazhimi dhe kontributi i personelit dhe njësive bazë në hartimin e projekteve, aplikimin apo fitimin e tyre është jashtëzakonisht i ulët

Këshilli i Botimeve (organ kolegjial), në ushtrim të kompetencave të tij, ka shqyrtuar kërkesat lidhur me miratimin si botime shkencore apo tekste mësimore (6 tekste në total), në përputhje me standardet, për botimet akademike në UMT, në fushën e mësimdhënies dhe aktivitetit shkencor. Ka vijuar publikimi online i revistës Albanian Journal of Medical and Health Sciences (nr.49 dhe 50).

Këshilli i Etikës (organ kolegjial), në ushtrim të kompetencave të tij, nuk ka pasur raste të

adresuara këtij organi lidhur me mosrespektimin të kërkesave të moralit dhe të etikës në realizim të funksionit të detyrave të individëve.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (organ kolegjal), në ushtrim të kompetencave të saj, ka angazhuar anëtarët e saj në nivel fakulteti në komisionet (ad-hoc) përkatëse për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, monitorimin e procesit të regjistrimeve dhe pranimeve, të kalueshmërisë në vit të studentëve aktivë etj. Në kuadër, NJSBC-ja, ka mbështetur dhe kërkuar më forcë ngritjen e strukturës përkatëse për sigurimin e cilësisë në nivel rektorati (sektori i sigurimit të cilësisë), (staf teknik), i cili në zbatim të politikave të cilësisë të UMT-së, ka për detyrë të grumbullojë dhe përpunojë të dhënat nëpërmjet sistemeve informatike, si përpunimin e pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e lëndës/ve, vlerësimin e shërbimeve që iu ofrohen studentëve nga administrata e UMT-së/fakulteteve, vlerësimin e performancës së pedagogeve, vlerësimin e infrastrukturës, të dhëna cilësore të studentëve në hyrje, në proces dhe në dalje, të dhëna lidhur me kërkimin shkencor të pedagogeve etj. NJSBC-ja, duke u bazuar te këto të dhëna statistikore, mund të bëjë analiza, rekomandime, sugjerime etj.

Në vitin akademik 2018-2019, nga ASCAL u zhvillua Sondazhi Kombëtar i Studentëve, dhe NJSBC-ja është në pritje të Raportit të rezultateve të studentëve të UMT, për të bërë analizat përkatëse.

NJSBC në bashkëpunim me Fakultetin e Mjekësisë dhe të Mjekësisë Dentare ka iniciuar vlerësimin në kuadër të akreditimit të programeve të studimit që ofron UMT. Për shkak të aspekti financiar, u miratua fillimi i procesit të akreditimit në 2019, për 3 programet e integruara të studimit që ofron FM dhe FMD (Mjekësisë e Përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci) të cilat do të përfundojnë në vitin 2020 (me urdhrin e akreditimit për secilin program).

NJSBC-ja ka realizuar funksionin e tyre kryesisht në nivel fakulteti, përkatësisht në analizimin e rezultateve të pyetësorëve me studentët, si dhe evidentimin e disa problematikave dhe dhënien e rekomandimeve përkatëse.

Lidhur me cilësinë e studentëve në hyrje (në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë), NJSBC-ja ka analizuar, në nivel universiteti dhe fakulteti, ecurinë e rezultateve (notave) të lëndëve biologji, kimi dhe fizikë, të studentëve që kanë përfunduar vitin e parë në vitin 2018, krahasuar me rezultatet (notat) e marra prej tyre në arsimin e mesëm po në këto lëndë (biologji, kimi, fizikë, grup-lëndë formuese si kriter pranimi në UMT), si dhe ka bërë analizën e trendit të cilësisë në hyrje (sipas grup lëndëve) për tri vitet e fundit.

Përsa i përket vlerësimin të cilësisë të programeve të studimit, përveç metodave të drejtpërdrejta (anketime, pyetësorë, formularë vlerësimi, etj), NJSBC ka përdorur dhe forma indirekte të tilla si: të dhëna për kalueshmërinë në provimet e licencës, korrelacionin e testimit me shkrim të specializanteve me notën mesatare në formimin në mjekësi të përgjithshme etj.

3.3 Njësitë administrative ndihmës akademike (rektorat/dekanat) dhe komisionet ad-hoc

Rektorati/dekanatet (si njësi administrative), në ushtrim të kompetencave të tyre, kanë zbatuar (vendimet e organeve kolegjiale apo drejtuese) dhe kanë nxjerrë akte rregullative lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor, të pranimeve dhe regjistrimeve në programet e studimit që ofron UMT-ja apo të transferimeve të studimeve, komisionet e monitorimit të aspekteve të

procesit mësimor (nga ana cilësore), dhënien e përgjigjes dhe të zgjidhjes për kërkesat/ankesat individuale apo në grup drejtuar UMT-së apo fakulteteve etj.

Gjithashtu, lidhur me organizimin e proceseve nga rektorati/dekanati, nëpërmjet komisioneve ad-hoc të ngritura për aspekte të veçanta të veprimtarisë akademike, evidentojmë se:

- Procesi i përlogaritjes së pikëve të maturantëve dhe rankimit të tyre, në kuadër të pranimeve në programet e studimit në UMT (gusht 2018), i kryer nga komisioni i monitorimit dhe grupi teknik (në nivel universiteti), i ngritur për këtë qëllim, janë realizuar me sukses.
- Procesi i pranimeve në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, që nga nxjerrja e akteve rregullative, proceset shumë të rëndësishme të aplikimit dhe të konkurrimit të studentëve, si dhe përzgjedhjes së programit specializues afatgjatë nga ana e tyre, kryhet dhe monitorohet tërësisht nga Rektorati i UMT-së dhe dekanatet e fakulteteve përkatëse.

Rrjeti i Studentëve të Ekselencës të UMT-së (NES-UMeD), (viti i dytë i ngritjes) bëhet mbi bazë vullnetare aplikimi. Përzgjedhja e studentëve u bë pas verifikimit të rezultateve të studimeve të tyre (kriter-nota mesatare mbi 9) nga njësitë kryesore përkatëse.

Gjatë viti të parë dhe të dytë të funksionimit të këtij rrjeti, u realizuan disa veprimtari, si takim me titullarin e institucionit dhe të fakulteteve, njohja me programet evropiane të shkëmbimit të studentëve (Erasmus+) dhe aplikimi për këto programe. Identifikohet se studentët e NES-UMeD duhen mbështetur, motivuar dhe nxitur më shumë nga UMT, për rritjen e pranisë së këtij rrjeti në jetën e universitetit, dhe rekomandimet për strukturën që monitorin këtë rrjet janë si më poshtë:

- studentët e NES-UMeD, të përfshihen në mënyrë aktive në informimin e maturantëve që synojnë të bëhen pjesë e UMT, si dhe zyrën e këshillimit të karrierës;
- të caktohet një person për ndjekjen në vazhdim të të gjitha veprimtarive dhe eventeve ku këta studentë mund të marrin pjesë, duke luajtur rolin e një ndërmjetësi dhe iniciuesi për përfshirjen e tyre në aktivitetet e ndryshme apo duke adresuar problematikat e hasura në njësitë përkatëse;
- të planifikohet një fond për NES-UMeD, me qëllim mbështetjen e nismave dhe veprimtarive të tyre, apo anëtarësimin e tyre në rrjetet ndërkombëtare simotra;
- të hapet një rubrikë në faqen zyrtare të interneti të UMT-së për publikimin e veprimtarive të NES-UMeD.

3.4 Aktiviteti i njësive kryesore

Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, janë organizuar në njësi bazë (departamente) sipas profilit të fushave të programeve të studimit që ofrojnë apo profilit të veprimtarisë lëndore, duke krijuar në këtë mënyrë mundësinë që departamentet të bashkërendojnë aktivitetet e tyre, në funksion të realizimit të procesit akademik e shkencor.

Po ashtu, departamentet dhe personeli akademik përkatës japin një kontribut të rëndësishëm në angazhimet për institucionin. Një pjesë e konsiderueshme e personelit akademik me kohë të plotë kanë qenë pjesë e komisioneve të përkohshme të vlerësimit të ngritura në nivel universiteti apo fakulteti. Në paragrafët e mëposhtëm jepet në mënyrë të përmbledhur aktiviteti i secilit nga fakultetet e UMT-së (informacioni i detajuar gjendet në raportet vjetore për vitin akademik

2018-2019 të secilit fakultet). Është identifikuar nevoja për riorganizimin e departamenteve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike me bazë profili programesh, për shkak të numrit të madh të programeve që mbulojnë (aktualisht janë 3 departamente që mbulojnë 19 programe studimi).

3.4.1 Fakulteti i Mjekësisë¹

Fakulteti i Mjekësisë ofron programe studimi të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të integruara të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, përkatësisht:

- Programe të integruara të ciklit të dytë, me kohëzgjatje 5 dhe 6 vite akademike, në përfundim të të cilave studenti pajiset me *Diplomë “Master i Shkencave në Mjekësi e përgjithshme”* ose *Diplomë “Master i Shkencave në Farmaci”*;
- Program i ciklit të parë Bachelor, me kohëzgjatje 3 vite akademike, në përfundim të të cilit studenti pajiset me *Diplomë “Bachelor në Shëndet Publik”*;
- Programe të ciklit të dytë, me kohëzgjatje 1 dhe 2 vite akademike, në përfundim të të cilave studenti pajiset me *Diplomë “Master i Shkencave në Shëndet Publik”*, *Diplomë “Master Profesional në Shëndet Publik”* ose *Diplomë “Master Profesional në Menaxhim Shëndetësor”*;
- Programe të ciklit të tretë, *Programe të Specializimeve Afatgjata*, në fushën e Mjekësisë (kohëzgjatja 3-4 vjet). Në Fakultetin e Mjekësisë, në vitin akademik 2018-2019 janë aktivizuar (studentë të regjistruar në vit të parë) 35 programet e specializimeve afatgjata të ofruara nga ky fakultet.

Për sa i përket programeve të Doktoratës, priten të aktivizohen në vitin akademik 2020-2021 (të cilat nuk janë hapur prej 5 vitesh në UMT).

Ndërkohë për doktorantët në proces (300 doktorantë në proces, nga të cilët 135 janë aktualisht në fund të procesit të mbrojtjes së gradës shkencor), të cilët nuk kanë vijuar më tej për shkak të pengesave administrative ligjore, është konstituar në FM, Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, dhe do vijohet normalisht me procedurat përkatëse.

Në Fakultetin e Mjekësisë, UMT, janë angazhuar **194** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive:

Personel akademik me kohë të plotë, 2018-2019 (PAKPI)					
	Profesor		Lektor	As. lektor	
Viti akademik	Prof.	Prof. Asc.	Dr.	Master	Totali
2018-2019	85	59	41	9	194

Për plotësimin e ngarkesës mësimore, pranë FM angazhohet personel akademik me kohë të pjesshme dhe personel akademik nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU), të pasqyruar

¹ Informacion i detajuar gjendet ne Raportin Vjetor 2018-2019, Fakulteti i Mjekësisë UMT

në tabelën e mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme, 2018-2019 (PAKPj)</i>			
Viti akademik	SSHU*	Të jashtëm	Totali
2018-2019	174	112	286

Në FM zhvillojnë veprimtarinë e mësimdhënies **480** anëtarë të personelit akademik: me kohë të plotë; staf i SSHU (strukturave shëndetësore universitare); me kohë të pjesshme, si dhe 49 personel ndihmës akademik dhe 23 personel administrativ. Fakulteti i Mjekësisë ka specifikën e vet në angazhimin e personelit të strukturave shëndetësore universitare* në mbështetje të procesit të mësimdhënies, ku i gjithë personeli i rrjetit spitalor universitare është i angazhuar në proceset e mësimdhënies.

Ngarkesa mësimore e realizuar sipas cikleve të studimit në FM, për vitin akademik 2018-2019, është si më poshtë:

<i>Ngarkesa mësimore sipas cikleve të studimit</i>		
Nr	Programi i studimit	Ngarkesa mësimore fizike
1	Bachelor	1495
2	PICD	7333
3	Master Profesional (Shëndet Publik dhe Menaxhim Shëndetësor)	1389
4	Master i shkencave	1236
5	Specializim Afatgjatë	0
6	Doktoraturë	0
	TOTAL	11453

Për vitin akademik 2018-2019, studentët e regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Programi	Bachelor	Master profesional	Master shkencor	SPA
Mjekësi e përgjithshme			290	
Farmaci			103	
Shëndet Publik	18	18	14	
Menaxhim shëndetësor		35		
Specializime				236
Total	18	53	407	236
<i>Të regjistruar në FM , viti i parë, gjithsej 714 studentë</i>				

Studentë që ndjekin aktualisht studimet (në të gjitha vitet, përfshirë dhe 2018-2019) janë:

Fakulteti i Mjekësisë	Bsc	M. Pr	Msc	PICD	SPA	Totali
	40	74	39	2737	715	3605

3.4.2 Fakulteti i Mjekësisë Dentare²

Fakulteti i Mjekësisë Dentare ofron programe të ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë dhe të tretë, të organizuara si më poshtë:

- Program i integruar i ciklit të dytë, me kohëzgjatje 5 vite akademike, në përfundim të të cilit

² Informacion i detajuar gjenden ne Raportin Vjetor 2018-2019, Fakulteti i Mjekësisë Dentare

studenti pajiset me *Diplomë “Master i Shkencave në Stomatologji”*;

- Programe të ciklit të parë “Bachelor”, me kohëzgjatje 3 vite akademike, në përfundim të të cilave, studenti pajiset me *Diplomë “Bachelor në Higjenist Dentar” ose Diplomë “Bachelor në Teknike Dentare”* (aktivizuar për herë të parë në vitin akademik 2018-2019);
- Programe të ciklit të tretë, *Specializime Afatgjata*, në fushën e Mjekësisë Dentare (kohëzgjatja deri në 4 vjet). Në Fakultetin e Mjekësisë Dentare studiojnë specializantë, të shpërndarë në 3 programe specializimi: “*Terapi Stomatologjike*” dhe “*Pedodonti*” në Departamentin e Terapisë, si dhe “*Kirurgji Maksilo-faciale*” në Departamentin e Kirurgjisë, ku realizohen orët sipas kurrikulës së miratuar.

Për sa i përket programeve të doktoratës, priten të aktivizohen në vitin akademik 2020-2021 (të cilat nuk janë hapur prej 5 vitesh në UMT).

Ndërkohë për doktorantët në proces (25 doktorantë), të cilët nuk kanë vijuar më tej për shkak të pengesave administrative ligjore, është konstituar në FMD, Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, dhe do vijohet normalisht me procedurat përkatëse.

Në Fakultetin e Mjekësisë Dentare janë angazhuar **21** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive:

<i>Personel akademik me kohë të plotë, 2018-2019 (PAKPI)</i>					
	Profesor		Lektor	As. lektor	Totali
Viti akademik	Prof.	Prof. Asc.	Dr.	Master	
2018-2019	5	6	8	2	21

Për plotësimin e ngarkesës mësimore, pranë FMD-së angazhohet personel akademik me kohë të pjesshme, personel akademik i ftuar (**personel akademik i FM-së i cili mbulon lënd[të formimit mjekësor*) dhe personel akademik i huaj, i cili ftohet për të zhvilluar module, cikle leksionesh, numri i të cilëve është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme, 2018-2019 (PAKPj)</i>				
Viti akademik	Të ftuar* (Fakulteti i Mjekësisë)	Të huaj	Të jashtëm	Totali
2018-2019	55	17	78	150

Ngarkesa mësimore e realizuar sipas cikleve të studimit në FMD, për vitin akademik 2018-2019, është si më poshtë:

Nr.	Programi i studimit	Ngarkesa mësimore orë të konvertuara
1	PICD	6490
2	Specializim Afatgjatë	1744.5
	TOTAL	8234.5

Për vitin akademik 2018-2019, studentë të regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Programi	Bachelor	Master shkencor	SPA
Stomatologji		126	
Teknikë Dentare	60		
Higjenist Dentar	60		
Specializime			10
Total	120	126	10

Studentë që ndjekin aktualisht studimet (në të gjitha vitet, përfshirë dhe vitin akademik 2018-2019) janë:

Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Bsc	PICD	SPA	Tot ali
	120	608	22	750

3.4.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike³

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ofron programe studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, të organizuara si më poshtë:

- Programe të ciklit të parë “Bachelor”, me kohëzgjatje 3 vite akademike (6 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Teknikë Laboratori, Logopedi.
- Programe të ciklit të dytë “Master Profesional”, me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 kredite (7 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Logopedi, Teknikë laboratorit dhe Kujdes Paliativ
- Programe të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, me kohëzgjatje 2 vite akademike, 120 kredite (6 programe), në drejtimet: Infermieri, Mami, Fizioterapi, Teknikë Imazherie, Logopedi, Teknik laboratorit

Për sa i përket programeve të doktoratës, priten të aktivizohen në vitin akademik 2020-2021 (të cilat nuk janë hapur prej 5 vitesh në UMT).

Ndërkohë për doktorantët në proces, të cilët nuk kanë vijuar më tej për shkak të pengesave administrative ligjore, është konstituar në FSHMT, Komisioni për dhënien e gradës shkencore “Doktor”, dhe do vijohet normalisht me procedurat përkatëse.

Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike janë angazhuar **67** anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të plotë, 2018-2019 (PAKPI)</i>					
Viti akademik	Profesor		Lektor	As. Lektor	Totali
	Prof.	Prof. Asc.	Dr.	Master	
2018-2019	5	8	28	30	71

Për plotësimin e ngarkesës mësimore, pranë FSHMT-së angazhohet personel akademik me kohë të pjesshme, personel akademik me kohë të pjesshme dhe personel akademik nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU) dhe njësi të tjera shëndetësore (shërbimit parësor), të pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme, 2018-2019 (PAKPj)</i>			
Viti akademik	Të jashtëm	SSHU +njësi të tjera shëndetësore	Totali
2018-2019	180	110	290

Në FSHMT zhvillojnë veprimtarinë e mësimdhënies në total **361** anëtarë të personelit

³ Informacion i detajuar gjendet ne Raportin Vjetor 2018-2019, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike UMT

akademik me kohë të plotë, personel akademik nga strukturat shëndetësore universitare (SSHU) dhe njësi të tjera shëndetësore (shërbimit parësor) dhe me kohë të pjesshme.

Për vitin akademik 2018-2019, studentë të regjistruar në vitin e parë janë si më poshtë:

Viti 2018-2019	Bachelor	Master profesional	Master shkencor
Infermieri	243	185	83
Mami	30	46	15
T. Laboratori	54	50	39
Fizioterapi	51	79	45
T. Imazherie	50	52	38
Logopedi	20	25	24
Total	448	437	244
<i>Në total 1129 studentë të regjistruar në vitin e parë</i>			

Studentë që ndjekin aktualisht studimet (në të gjitha vitet, përfshirë dhe vitin akademik 2019-2020) janë:

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Bsc.	M. Pr	Msc.	Totali
	1284	437	482	2203

3.5 Sekretaritë mësimore në njësitë kryesore

Sekretaria mësimore është njësi në funksion të procesit mësimor dhe studentëve. Personeli i sekretarisë mësimore është përgjegjës për të gjitha procedurat që ka kryer fakulteti gjatë vitit akademik në lidhje me regjistrimet, transferimet dhe procesin mësimor.

Konkretisht, me fillimin e vitit të ri akademik, sekretaria:

- hap regjistrat e notave ku pasqyrohen studentët sipas grupeve, kurrikulave për vitet e para, të dyta e në vazhdim, të cilët vazhdojnë studimet në fakultet;
- regjistrat elektronikë ku pasqyrohen studentët sipas grupeve, kurrikulave për të gjitha vitet, të cilët vazhdojnë studimet në fakultetin përkatës;
- hedh të dhënat dhe gjeneralitetet e secilit student në Regjistrin Themeltar dhe në formë elektronike, për të mundësuar:
 - pajisjen e tij me numër matrikullimi;
 - aktivizimin e studentit elektronikisht në Sistemin e RASH-it;
- nxjerr statistikën për studentët sipas viteve të studimit (femra/meshkuj; fshat/qytet; trojet, shpërndarja sipas grupmoshave për studentët e diplomuar, për studentët që kanë kaluar në vitin pasardhës);
- përgatit regjistrat e pedagogëve me emrat e studentëve sipas programeve të studimit dhe grupeve përkatëse për çdo semestër;
- hedh notat e procesverbaleve të provimeve në regjistrin e notave dhe atë elektronik, si dhe harton procesverbalet në përputhje me kërkesat me shkrim të studentëve, duke u mbështetur në rregulloren e fakultetit.

Sekretaria mësimore përgatit listat përfundimtare të studentëve që frekuentojnë vitin pasues pas përfundimit të sezonit të vjeshtës dhe para fillimit të vitit akademik. Gjithashtu, ajo përgatit certifikatën e notave të studentëve të diplomuar dhe mbledh dokumentet e duhura nga studentët për të gjitha shërbimet e kërkuara nga ana e tyre sipas listës së shërbimeve që ofron UMT-ja.

IV. VEPRIMTARIA AKADEMIKE

4.1 Programet e studimit

UMT-ja në vitin akademik 2018-2019 ka aktivizuar programe studimi **të ciklit të parë me kohë të plotë** përkatësisht:

- 9 (nëntë) programe studimi Bachelor në
 - Infermieri, Mami, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi (FSHMT);
 - Shëndet Publik (FM).
 - Teknikë Dentare dhe në Higjienist Dentar (FMD)

UMT-ja në vitin akademik 2018-2019 ka aktivizuar programe studimi **të integruara të ciklit të dytë me kohë të plotë** përkatësisht:

- 3 (tri) programe studimi të integruara
 - Master i Shkencave në Mjekësi të Përgjithshme dhe në Farmaci (FM),
 - Master i Shkencave në Stomatologji (FMD).

UMT-ja në vitin akademik 2018-2019 ka aktivizuar programe studimi **të ciklit të dytë me kohë të plotë** përkatësisht:

- 9 (nëntë) programe studimi Master Profesional (60 ECTS)
 - Infermieri, Mami, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi dhe Kujdes Paliativ (FSHMT);
 - Shëndet Publik dhe Menaxhim Shëndetësor (FM).
- 7 (shtatë) programe studimi Master i Shkencave (120 ECTS)
 - Infermieri, Mami, Teknikë Laboratori, Teknikë Imazherie, Fizioterapi, Logopedi (FSHMT);
 - Shëndet Publik (FM).

UMT-ja vitin akademik 2018-2019 ka aktivizuar programe studimi **të ciklit të tretë specializime afatgjata në fushën e mjekësisë dhe stomatologjisë**, përkatësisht:

- 38 (tridhjetë e tetë) programe studimi specializime afatgjata në fushën e mjekësisë nga të cilat:
 - 35 programe të specializimeve afatgjata që ofron Fakulteti i Mjekësisë
 - 3 programe specializimi afatgjata që ofron Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

Ndërkohë këtë vit priten të riaktivizohen dhe programet e doktoratës që ofron UMT-ja

Programet e studimit që ofron UMT-ja janë profesione të rregulluara, ndaj hartimi i programeve të studimit duhet të bazohet edhe në Direktivat Evropiane për Profesionet e Rregulluara, konkretisht me Direktivën 2013/55/EC dhe Direktivën 2005/36 / EC, të Bashkimit Evropian (BE), mbi Njohjen e Kualifikimeve Profesionale.

Programet e studimit që ofrohen në njësitë kryesore të UMT-së, janë objekt rishikimi periodik (çdo fillim viti akademik), në plotësim të standardeve evropiane dhe atyre shtetërore të cilësisë.

Për plotësimin e këtyre direktivave, viti akademik 2018-2019 ka qenë mjaft dinamik në lidhje me përmirësimin/riorganizimin e programeve të studimit në përputhje me aktet ligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 80/2015.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*”, nga Grupet e Punës të ngritura në nivel fakulteti dhe të asistuar nga drejtoria përgjegjëse për kurrikulat në Rektorat, është bërë riorganizimi i programeve të studimit, planeve mësimore dhe syllabuseve të lëndëve, në përputhje me VKM-në e sipërcituar. Grupet e punës, në bashkëpunim me departamentet përkatëse dhe Drejtorinë përgjegjëse për kurrikulën në UMT, shqyrtuan dhe analizuan programet për të bërë ndryshimet e nevojshme.

Veprimtaritë formuese janë grupuar në kategori sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018, duke i ndarë në lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme; lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij; lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe gruplëndë me zgjedhje; *lëndë plotësuese*, të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat klinike/profesionale të zhvilluara pranë QSUT-së dhe strukturave të tjera universitare dhe jouniversitare shëndetësore, si dhe tezën e diplomës dhe/ose provimin përfundimtar.

Në këtë kuadër, nga Fakulteti i Mjekësisë është propozuar riorganizimi i Specializimit Afatgjatw në Nefrologji, bazuar në Direktivën 2005/36/EC, Standardet shtetërore të cilësisë për programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe stomatologjisë (miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin), në strategjinë e Ministrisë të përgjegjëse të shëndetësisë, si dhe në plotësimin e nevojave të sektorit shëndetësor. Pavarësisht, plotësisë së dokumentacionit sipas akteve normative në fuqi, riorganizimi i programi SPA në Nefrologji nuk u shqyrtua nga Ministria përkatës. Aktualisht po përshtatet programi i riorganizuar me Udhëzimin e ri nr.1, datë 14.01.2020 të MASR dhe do aplikohet brenda afateve të kërkuara.

Nga FSHMT-ja është rievidentuar një problematikë në lidhje me përshtatjen dhe përafrimin e programeve të shkencave mjekësore teknike (që ofron FSHMT-ja) me praktikat më të mira evropiane dhe rekomandimet që vijnë nga bashkëpunëtorët dhe Urdhri i Infermierëve i Shqipërisë.

Konkretisht, bazuar në propozimin e FSHMT-së, në Direktivën 2005/36/EC dhe Direktivën 2013/55/EU të Bashkimit Evropian, për programet e studimit në fushën e shkencave mjekësore teknike, Rektorati i ka kërkuar MASR-së zbardhjen e udhëzimeve specifike për organizimin e studimeve në drejtimit teknike të shkencave mjekësore si infermieri, akte të cilat duhet të rregullojnë programet e këtij lloji në nivel kombëtar dhe jo vetëm për FSHMT, mbështetur në direktivat e BE si dhe përmirësimin e cilësisë së formimit profesional të infermierëve.

FSHMT, bazuar në propozimet me partnerët dhe tregun e punës, ka në proces studimin e tregut dhe hartimit të një programi: Master Profesional “*Infermieri në Familje*”. Ky program do të hartohet sipas një kurrikule bashkëkohore të mbështetur në kompetenca infermierore. Ekziston një nevojë e artikuluar qartë për të krijuar një program të tillë në mënyrë që të forcohet trajnimi i kësaj kategorie profesionale që do të jetë në gjendje t'i përgjigjet nevojave në rritje të komunitetit. FSHMT po bashkëpunon ngushtë me *Fondacionin HAP - Health for All Project*, në mënyrë që të zhvillojë dhe zbatojë një program profesional Master Infermieri në Familje.

4.2 *Procesi mësimor, mësimdhënia dhe vlerësimi*

Mësimdhënia në njësitë kryesore të UMT-së është organizuar në bazë të veprimtarive formuese dhe përbërësve mësimorë të programit të studimit, të cilët ndahen në mësim në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, praktika klinike, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor, studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh, përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës e praktika profesionale.

Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo lëndë/modul, është e përcaktuar në planet mësimore të programeve të studimit, në bazë të krediteve që ka secila lëndë/disiplinë. Në përgjithësi procesi mësimor organizohet në përputhje me profilin e disiplinës, veprimtarisë formuese dhe nivelit të programit të studimit. Personeli akademik ka liri të plotë në organizimin e procesit mësimor, në përputhje me planin e miratuar dhe syllabuset e lëndëve.

Në nivel fakulteti kryhen monitorime periodike për të parë realizimin e programit mësimor në përputhje me planin e miratuar. Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe ruajtja e etikës profesionale të personelit akademik ka qenë në fokus të vazhdueshëm nga fakultetet e UMT-së gjatë vitit akademik 2018-2019. Për këtë qëllim njësitë kryesore kanë ngritur komisione ad hoc (ku një anëtar këtij komisioni është i NjSBC-së), me fokus kryesor monitorimin e procesit mësimor, si dhe metodat e mësimdhënies dhe etikës së komunikimit të stafit me studentët, me qëllim vlerësimin në tërësi të cilësisë e mësimdhënies në nivel fakulteti.

Gjithashtu, drejtuesit e departamenteve dhe dekanët e fakulteteve kanë organizuar takime të drejtpërdrejta me përfaqësues të studentëve, për të marrë mendimin e tyre në lidhje me problematika eventuale të realizimit të procesit mësimor.

Gjatë vitit 2019, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), për ofrimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe për të ofruar një shërbim sa më të sigurt e cilësor ndaj studentëve, nisi realizimi i digjitalizimit të sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave të studentëve (ESSE3), për të automatizuar proceset e sekretarive mësimore dhe shërbimeve ndaj studentëve.

Qëllimi kryesor i implementimit të këtij sistemi informatik të integruar është digjitalizimi i punës, procedurave mësimdhënëse dhe procedurave administrative të sekretarive mësimore të universitetit. Evidentohet se ende nuk ka përfunduar implementimi i plotë i këtij sistemi, duhen marrë masat të menjëhershme për implementimin dhe funksionimin e plotë të sistemit

Referuar analizave vjetore të fakulteteve, rezulton se në funksion të procesit të mësimdhënies, është në fokus dhe përdorimi i formave inovative të mësimdhënies sikundër janë platformat Moodle, Classroom, etj., të cilat krijojnë mundësi ndërveprimi në kohë reale ndërmjet stafit akademik dhe studentit, shkëmbimi materiale didaktike në kohë reale, si dhe mundësi diskutimi dhe vlerësimi të vazhdueshëm të studentëve.

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet marrjes së mendimit dhe të studentëve, me metoda gjerësisht të njohura të sondazheve anonime, mundësojnë një vlerësim në masë të gjerë të performancës së stafit dhe evidentimit të problematikave. Lidhur me këtë aspekt, rievidentohet fakti që marrja e mendimit të studentëve nëpërmjet sondazheve (anonime), si dhe

përpunimi (bruto) i rezultateve të sondazhit me studentët, të bëhet në formë digjitale (nëpërmjet sistemit ESSE3), për të siguruar dhe garantuar një proces transparent dhe korrekt.

Monitorimi i cilësisë së mësimdhënies është proces i vazhdueshëm dhe i vështirë. Në plotësim të standardeve të cilësisë, ku ky aspekt zë një vend të veçantë, duhet të ngrihen mekanizma të përhershëm të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, duke bërë pjesë dhe studentët, si nëpërmjet marrjes së mendimit/sondazheve, ashtu edhe duke i përfshirë ata në komisionet e përhershme dhe ato të përkohshme. Aktualisht, këta mekanizma janë parashikuar në draft-statutin e ri të UMT-së dhe do të detajohen edhe në rregulloren e UMT-së dhe rregulloret e fakulteteve.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është i vetmi institucion i arsimit të lartë në vend i cili ka përcaktuar si kriter pranimit notën mesatare në hyrje për secilin nga programet e studimit (për PICD $\geq$ 8.5 dhe për Bsc $\geq$ 7.5 nga nota minimale 6 përcaktuar me VKM nr. 216, datë 20.04.2018⁴). Pavarësisht këtij kufizimi, për vitin akademik 2018-2019, numri i aplikantëve për të gjitha programet e studimit në të dy raundet e aplikimit (nëpërmjet portalit U-Albania) ishte 8,729 aplikantë (duke llogaritur aplikimin vetëm për një program studimi) dhe 27,645 aplikime (rasti kur një aplikantë ka përzgjedhur më shumë se 1 (një) program studimi të UMT-së).


Tabela e detajuar e aplikimeve sipas programeve të studimit që ofron UMT-ja, për kandidatët vendas:

Viti akademik	2018-2019		
	Aplikime	Kuota	Mesatarja e kërkesave për një kuotë
Mjekësi e përgjithshme	3180	260	12.23
Farmaci	2460	100	24.60
Shëndet publik	1260	18	70.00
Fizioterapi	3325	50	66.50
Teknikë Imazherie	2756	50	55.12
Infermieri e përgjithshme	4205	240	17.52
Logopedi	1614	20	80.70
Mami	1035	32	32.34
Teknikë laborator	3134	50	62.68
Stomatologji	2758	100	27.58
Teknike Dentare	1428	60	23.80
Higjenist Dentar	490	60	8.17
Aplikantë/Kuota TOTAL	27645	1040	26.58

NjSBC-ja, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Menaxhimit Akademik, Rektorati i UMT-së, ka bërë një analizë të detajuar duke krahasuar rezultatet e studentëve të UMT-së në grup lëndët formuese (kimi, fizikë, biologji), me rezultatet me të cilat janë vlerësuar ata gjatë tri viteve të arsimit të mesëm si dhe me rezultatet në provimeve e Maturës Shtetërore. Nga analiza ka rezultuar se:

⁴ http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/VKM_nr._2162c_date_20.4.2018.pdf

Përqindjet e studentëve që kanë rezultuar me		
	Arsimi i mesëm	Matura Shtetërore
Rritje note në UMT krahasuar me	0.2%	10.2%
Diferencë deri në 2 nota nga	25.1%	44.3%
Diferencë 2-3 nota nga	26.3%	23.1%
Diferencë me shumë se 3 nota nga	48.4%	22.4%
Totali	100.00%	100.00%




Kjo analizë u krye për të përcaktuar cilësinë në hyrje të maturantëve dhe për të kuptuar cili prej vlerësimeve (ai gjatë arsimit të mesëm apo ai në provimet e maturës shtetërore) është më afër njohurive reale të tyre.

Siç duket qartë nga tabela dhe grafiku, mbi **50%** e studentëve ruajnë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, pak a shumë të njëjtat rezultate si ato me të cilat janë vlerësuar në maturën shtetërore duke mos pasur luhatje më të mëdha se me 2 nota, madje rreth **10%** e tyre kanë rezultuar me vlerësime më të larta në UMT.

Për të kuptuar dhe krahasuar, ndryshimin e cilësisë së maturantëve në hyrje, gjatë viteve të fundit, kemi përmbledhur në formë tabelore, përqindjet e studentëve me devijim të rezultateve, si më poshtë:

Luhatjet e notave në vite	Deri në 2 nota	2-3 nota	>3
Brezi 2016-2017	35.0%	20.0%	45.0%
Brezi 2017-2018	41.0%	18.0%	41.0%
Brezi 2018-2019	54.5%	23.1%	22.4%



Nga të dhënat e mësipërme, është lehtësisht e dallueshme se cilësia e maturantëve që përthith Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka një trend rritës nga viti në vit.

Informacioni lidhur me metodologjitë e vlerësimit të studentëve gjendet në çdo program studimi, në rregulloren e fakultetit dhe specifikisht në syllabuset e lëndëve/moduleve. Organizimi i provimeve është semestral ose vjetor në varësi të lëndës dhe programit.

Rezultatet e studentëve në vite, kompetencat dhe aftësitë profesionale të fituara janë në nivel të kënaqshëm dhe përmbushin kërkesat aktuale të tregut të punës në lidhje me nivelin e kualifikimit, që dëshmon se në UMT diplomohen studentë të aftë profesionalisht për të shërbyer në çdo nivel të shërbimit shëndetësor, brenda dhe jashtë vendit.

Numri i madh i programeve të studimit që janë lëshuar për studentët e diplomuar në UMT tregon se këta studentë janë mjaft të kërkuar dhe të vlerësuar nga tregu ndërkombëtar i punës.


Gjithashtu, rezultatet e Provimit të Shtetit për vitin 2018-2019 tregojnë se arritjet e të diplomuarve në UMT janë më të lartat në nivel kombëtar (kalueshmëria e të diplomuarve të UMT në Provimin e Shtetit ishte rreth 80%).

V. PERSONELI AKADEMIK DHE AKTIVITETET E REALIZUARA

5.1 Personeli akademik



Në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar në total **1012** anëtarë të personelit akademik përkatësisht personel akademik me kohë të plotë (PAKPI), personel akademik që vijnë nga struktura shëndetësore universitare dhe jouniversitare (PASSHU)+te ftuar dhe personel akademik me kohë të pjesshme (PAKPj), si më poshtë:

Personeli akademik	Numri total
Me kohë të plotë (PAKPI)	286
SSHU + Str. të tjera shëndetësore (PASSHU)+Te ftuar	356
Me kohë të pjesshme (PAKPj)	370
TOTALI	1012




Numri i anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programet e studimit që ofron UMT-ja është **286**.

Personel akademik me kohë të plotë, 2018-2019 (PAKPI)					
Njësia kryesore	Profesor		Lektor	As.Leko ose	Totali
	Prof.	Prof. Asc.	Dr.	Master	
Fakulteti i Mjekësisë	85	59	41	9	194
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	5	6	8	2	21
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	5	8	28	30	71
TOTAL	95	73	77	41	286



Nga të dhënat e tabelave të mësipërme rezulton se **86%** e të gjithë personelit akademik me kohë të plotë në nivel universiteti janë me tituj akademik ose gradë shkencore (**33%** janë me titull “Profesor”, **26%** me titullin “Profesor i Asociuar” dhe **27%** me gradën shkencore “Doktor”).




Referuar të dhënave nga sektori i burimeve njerëzore, evidentohet se të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë bazë në UMT plotësojnë detyrimin ligjor për sa i përket personelit akademik dhe titujve akademikë dhe gradave shkencore.


UMT-ja, ka në përbërje të saj strukturat shëndetësore universitare (ligji nr. 80/2015, neni 28) dhe departamentet, si njësi bazë, kanë në përbërjen e tyre shërbime dhe specialitete të ndryshme, në varësi të funksionit të veprimtarisë së tyre. Shërbimet kryejnë funksion të dyfishtë: akademik dhe kërkimor-shkencor si njësi akademike të UMT-së, si dhe shërbim terciar, diagnostikues e trajtues, si njësi të strukturës shëndetësore universitare spitalore të sistemit shëndetësor në vend. Në bazë të kësaj strukture, kryhet aftësimi akademik, praktik e klinik i studentëve, specializantëve, si dhe veprimtaria kërkimore-shkencore e doktorantëve dhe e personelit akademik, si dhe njëkohësisht ofrohet shërbim shëndetësor ndaj popullatës.

Nisur nga kjo formë organizimi dhe funksionimi, praktikisht e gjithë infrastruktura dhe kapacitetet njerëzore të qendrave spitalore universitare në vend, përveç ofrimit të shërbimit shëndetësor në vend, janë njëkohësisht në funksion të edukimit e kërkimit shkencor mjekësor, si pjesë e UMT-së (VKM-të përkatëse për krijimin e strukturave shëndetësore universitare në vend). Në këtë kuadër, në mbështetje të procesit mësimor në UMT, për vitin 2018-2019 janë angazhuar **40%** anëtarë të personelit akademik, të punësuar më kohë të plotë në strukturat shëndetësore në vend.

Personel akademik i ftuar dhe i huaj i angazhuar në UMT janë 10%, ndërsa personel akademik me kohë të pjesshme (që vijnë nga IAL-të e tjera) të angazhuar për vitin akademik 2018-2019 janë 50%.

<i>Personel akademik me kohë të pjesshme në UMT, për vitin akademik 2018-2019 (PAKPj)</i>				
Njësia kryesore	Të jashtëm	SSHU + Str. të tjera shëndetësore	Të ftuar + të huaj	Totali
Fakulteti i Mjekësisë	112	174		286
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	78		55+17	150
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	180	110		290
TOTAL	370	284	72	726





Procedura për përzgjedhjen e PAKPj kryhet çdo vit në përputhje me nevojat që kanë njësitë bazë për mbulimin e ngarkesës mësimore. Në fillimin e vitit akademik 2018-2019, procedura për përzgjedhjen e personelit akademik me kohë të pjesshme u bë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Ngarkesa mësimore është planifikuar dhe realizuar në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtaritë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, për vitin akademik 2018-2019.

IV. KËRKIMI SHKENCOR

6.1 Fakulteti i Mjekësisë

Veprimtaritë shkencore, seminarët, Workshop-et, aktivitetet e edukimit në vazhdim, konferencat, kongreset, projektet (aplikuar dhe fituar), të zhvilluara nga Fakulteti i Mjekësisë, gjenden të detajuara në Raportin Vjetor të Fakultetit të Mjekësisë.

6.2 Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Veprimtaritë shkencore, seminarët, Workshop-et, aktivitetet e edukimit në vazhdim, konferencat, kongreset, projektet (aplikuar dhe fituar), të zhvilluara nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare, gjenden të detajuara në Raportin Vjetor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare.

6.3 Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike

Veprimtaritë shkencore, seminarët, Workshop-et, aktivitetet e edukimit në vazhdim, konferencat, kongreset, projektet (aplikuar dhe fituar), të zhvilluara nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, gjenden të detajuara në Raportin Vjetor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike.

6.4 Aktiviteti kërkimor-shkencor 2018-2019

Nr.	Aktivite/Veprimtari	FM	FMD	FSHMT
1	Botime në revista shkencore brenda vendit	97	21	2
2	Botime në revista shkencore jashtë vendit	126	18	0
3	Botime në revista shkencore me faktor impakti	51	1	1
4	Botime në revista shkencore me pjesëmarrjen e studentëve	18	NA	NA
5	Referime në Konferenca/Seminar shkencor brenda vendit	393	51	32
6	Referime në Konferenca/Seminar shkencor jashtë vendit	254	47	16
7	Referime në Konferenca/Seminar shkencor ku janë përfshirë studentët	66	2	NA
8	Pjesëmarrje në projekte kombëtare	30	NA	NA
9	Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare	13	NA	NA
10	Pjesëmarrje në borde drejtuese të revistave shkencore	8	NA	NA
11	Botim librash	16	NA	NA
12	Botim monografi	6	NA	NA
13	Studentë në programe të ndryshme (Erasmus, Erasmus+, etj.)	17		

NA-Nuk ka të dhëna

6.5 Bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel universiteti

Informacion mbi bashkëpunime ndër-institucionale dhe projekte ku merr pjesë Universiteti i Mjekësisë, Tiranë							
Nr.	Informacion mbi institucionin bashkëpunues apo projektin	Lloji i kontratës	Data e nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunim	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit	Fusha e bashkëpunimit	Detyrat e palëve dhe produktet	Rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim
1	Kuvendi i Shqipërisë	Marrëveshje e kuadër	31.10.2018	Nënshkrim i marrëveshjes	Bashkëpunimi i dy institucioneve në	Nxjtja e bashkëpunimit	Realizimi i synimeve të

				nga të dyja palët	fusha të ndryshme	it të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	përbashkëta, në kuadër të zhvillimit Institucional
2	Qendra nderinstitucionale e rrjetit akademik shqiptar (RASH)	Marrëveshje kuadër	05.11.2018	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Bashkëpunimi i dy institucioneve në fusha të ndryshme	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional
3	Trakya University	Marrëveshje kuadër	16.11.2018	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Shkëmbimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore me interesa të përbashkëta të dy institucioneve, bashkëpunim në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional
4	Ljubljana University	Marrëveshje kuadër	12.12.2018	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Shkëmbimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore me interesa të përbashkëta të dy institucioneve, bashkëpunim në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional
5	Universiteti Teramo, Itali	Marrëveshje kuadër	19.12.2018	Nënshkrim i marrëveshjes ngatë dyja palët	Shkëmbimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore me interesa të përbashkëta të dy institucioneve, bashkëpunim në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional
6	Bezmialem Vakif University	Marrëveshje kuadër	28.12.2018	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Shkëmbimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore me interesa të përbashkëta të dy institucioneve, bashkëpunim në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional

7	Tallinn health care college, Estonia	Marrëveshje kuadër	28.12.2018	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Shkëmbimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore me interesa të përbashkëta të dy institucioneve, bashkëpunim në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional
8	Universiteti Camerino, Itali	Marrëveshje kuadër	28.01.2019	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Shkëmbimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore me interesa të përbashkëta të të dyja institucioneve, bashkëpunim në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional
9	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Marrëveshje kuadër	02.05.2019	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Bashkëpunimi i dy institucioneve në fusha të ndryshme	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional
10	Fidia Pharma Group	Marrëveshje kuadër	23.05.2019	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Shkëmbimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore me interesa të përbashkëta të të dyja institucioneve, bashkëpunim në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm, në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional
11	Kolegji AAB, Prishtine Kosovo	Marrëveshje kuadër	26.07.2019	Nënshkrim i marrëveshjes nga të dyja palët	Shkëmbimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore me interesa të përbashkëta të dy institucioneve, bashkëpunim në programe ndërkombëtare të arsimit dhe kërkimit shkencor	Nxitja e bashkëpunimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional	Realizimi i synimeve të përbashkëta, në kuadër të zhvillimit institucional

6.6 Shkëmbimet në kuadër të Programit Erasmus+

Shkëmbimet e studentëve të dërguar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë:

EMRI I PROJEKTIT	PROGRAMI	PERIUDHA E SHKËMBIMIT	KOORDINATORI	ROLI I UMT	NR. I MOBILITETEVE
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti i Saarlandit, në Gjermani	Universitet Partner	4
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti i Aquilas, Itali	Universitet Partner	3
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti "Ondokuz Mayıs", Samsun, Turqi	Universitet Partner	1
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti i Craioves, Rumani	Universitet Partner	3
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti i Camerinos, Itali	Universitet Partner	2
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Fidia Pharma (Padova, Itali)	Institucion partner	4

Shkëmbimet e stafit akademik të dërguar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë:

EMRI I PROJEKTIT	PROGRAMI	PERIUDHA E SHKËMBIMIT	KOORDINATORI	ROLI I UMT	NR. I MOBILITETEVE
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti i Saarlandit, në Gjermani	Universitet Partner	2

Shkëmbimet e stafit administrativ të dërguar nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë:

EMRI I PROJEKTIT	PROGRAMI	PERIUDHA E SHKËMBIMIT	KOORDINATORI	ROLI I UMT	NR. I MOBILITETEVE
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti "Ondokuz Mayıs", Samsun, Turqi	Universitet Partner	1
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti i Craioves, Rumani	Universitet Partner	2
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Fidia Pharma (Padova, Itali)	Institucion partner	1

Shkëmbimet e stafit akademik të ardhur në Universiteti i Mjekësisë, Tiranë:

EMRI I PROJEKTIT	PROGRAMI	PERIUDHA E SHKËMBIMIT	KOORDINATORI	ROLI I UMT	NR. I MOBILITETEVE
ERASMUS+	Erasmus+	2018-2019	Universiteti "Ondokuz Mayıs", Samsun, Turqi	Universitet Partner	1

6.7 Anëtarësimi i UMT-së në rrjete ndërkombëtare

Balkan Universities Association (BUA): Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtar me të drejta të plota në Shoqatën e Universiteteve të Ballkanit (BUA). BUA është një rrjet universitar, që përbëhet nga 66 universitete anëtare dhe përfshin vendet e Ballkanit dhe Evropës Lindore. Ky rrjet është krijuar për të mundësuar lidhje të ngushta mes universiteteve të Ballkanit në ofrimin e programeve të përbashkëta të studimit, shkëmbimin studentor dhe të personelit akademik, si dhe në punimet e përbashkëta shkencore.

Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF): Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtar i këtij rrjeti në cilësinë e anëtarit vëzhgues. Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF), e krijuar 50 vite më parë, bashkon mbi 800 universitete nga më shumë se 100 vende të botës, rrjete universitare, qendra kërkimore-shkencore dhe përfaqëson një nga agjencitë më të mëdha të institucioneve të arsimit të lartë në botë.

UNIADRION: Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është anëtarësuar në UNIADRION, që përfaqëson një shoqatë universitetesh dhe qendrash kërkimore të zonës adriatiko-joniane, themeluar në vitin 2000. Qëllimi i UNIADRION-it është bashkëpunimi midis universiteteve dhe qendrave kërkimore, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe favorizimin e përparimit të kulturës, shkencës, trajnimit dhe kërkimit në vendet e zonës adriatiko-joniane.

6.8 Aktivitete të edukimit të vazhdim, të akredituara nga Qendra e Zhvillimit Profesional në UMT

Gjatë vitit 2019, Qendra e Zhvillimit Profesional në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, ka akredituar aktivitetet si më poshtë vijon:

Nr	Titulli i Aktivitetit	Ofruesi	Kreditet	Data kur zhvillohet
1	Konferencë "Përditësimi mbi patologjitë e rrugëve respiratore që çdo profesionist shëndeti duhet të dijë" - perseritur 6 here ne rrethe te ndryshme	Fakulteti i Mjekësisë, Shërbimi i Pediatriisë Infektive,	24	09.03.2019
2	Fizioterapia Klinike	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	3	06.03.2019
3	Gjenetika: jo më alternativë, tashmë zgjidhje	Fakulteti i Mjekësisë, Shërbimi i Onkohematologjisë Pediatrike	3	12.03.2019
4	Sëmundjet retinale dhe trajtimet me injeksione anti-VEGF. Glukoma dhe trajtimi i saj	Fakulteti i Mjekësisë, Shërbimi i Okulistikës	5	24.04.2019
5	Kursi i trete i Ekografise ne Praktiken Klinike	Fakulteti i Mjekësisë	6	02.05.2019
6	Qasjet genetike ne praktiken mjekesore	Fakulteti i Mjekësisë, Shërbimi i Gjenetikës	9	13-16 Maj 2019
7	Qasjet Nefrologjike ne dobi te mjekut te familjes	Fakulteti i Mjekësisë, Shërbimi i Nefrologjisë	36	20-24 Maj 2019
8	Dementia Master Class 3 (Tirana Meeting) - Interprofessional Dementia Management	Fakulteti i Mjekësisë	19	22-24 Maj 2019

9	Alzheimer's - Disease Lights and Shadoës	Fakulteti i Mjekësisë	6	24.05.2019
10	Njohja, vlerësimi, Diagnoza dhe rrugët e mjekimit të Insuficiencës Kardiake - eshte bere 8 here ne rrethe te ndryshme	Fakulteti i Mjekësisë, Shërbimi i Mjekësisë Interne	24	25.05.2019
11	Takimi i pranveres se Endokrinologjise 2019	Fakulteti i Mjekësisë, ISHP	5	01.06.2019
12	Përditësim në Endokrinologjinë Pediatrike	Fakulteti i Mjekësisë	4	14.06.2019
13	360 gradë rreth Karcinomës së Tiroides	Fakulteti i Mjekësisë	4	28.06.2019
14	Konferenca me temë "Kujdesi Paliativ"	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	5	4-5.07.2019
15	"Depistimi i hershem I degjimit dhe sherbimet rehabilituese	Fakulteti i Mjekësisë	5	20.07.2019
16	Hereditary and environmental risk factors associated ëith sudden cardiac death	Fakulteti i Mjekësisë, ISHP	1	09.09.2019
17	Konferenca 27 Kirurgjikale Shqiptare	Fakulteti i Mjekësisë,	12	22-24 Tetor 2019
18	Sfidat e te ushqyerit ne terapite inovative	Fakulteti i Mjekësisë,	3	11.10.2019
19	Tetori Roze	Fakulteti i Mjekësisë,	2	22.10.2019
20	Kujdesi gjate shtatezanise dhe lindjes	Fakulteti i Mjekësisë,	15	24-26.10.2019
21	Perditesim ne gliomat cerebrale dhe kancerin e kokes	Fakulteti i Mjekësisë,	4.2	4.11.2019
22	Konferenca Ballkanike e Mikrobiologjise	Fakulteti i Mjekësisë,	15	21-23 Nentor 2019
23	Konferenca e dyte e shkencave teknike diagnostikuesedherehabilituese.Sfidat dhe prespektiva	Fakulteti i Mjekësisë,	6	22.11.2019
24	Konference "Kurs i 8 i Mikrokirurgjise"	Fakulteti i Mjekësisë,	21.6	11-12, 13-14, 15-16 nëntor 2019
25	Fokus mbi ekografine abdominale"	Fakulteti i Mjekësisë,	8.5	1-2 Nëntor 2019
26	Integrimi i kërkimit dhe praktikës klinike në shëdetin mendor	Fakulteti i Mjekësisë,	4	23.10.2019

VII. INFRASTRUKTURA DHE LOGJISTIKA NË FUNKSION TË AKTIVITETIT AKADEMIK

7.1 Infrastruktura, logjistika dhe shërbimet

Fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, zhvillojnë aktivitetin akademik dhe procesin mësimor në godinat si më poshtë:

1. Godina Qendrore
2. Godina e Lëndëve Paraklinike
3. Godina e Anatomisë
4. Godina e Mjekut të Familjes
5. Godina Galileo Galilei
6. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik
7. Godina nr. 1 e Shkencave Mjekësore Teknike
8. Godina nr. 2 e Shkencave Mjekësore Teknike
9. Godina e Mjekësisë Dentare

Theksojmë faktin se vendndodhja e godinave në funksion të veprimtarisë akademike, kërkimore e shkencore është në kampuse universitare spitalore (përveç Godinës Qendrore dhe Godinës së Farmacisë dhe Shëndetit Publik), lehtësisht të arritshme nga studentët nëpërmjet transportit publik për në spitalet universitare.

UMT-ja, referuar aseteve infrastrukturore në pronësi të saj, me një sipërfaqe rreth 20 000 m²(nga të cilat 14958 m² në funksion të procesit mësimor dhe 5000 m² në funksion të veprimtarisë administrative), disponon auditorë, klasa, laboratore, mjedise për personelin akademik, salla mbledhjeje, salla kompjuterësh etj., si më poshtë:

1. Godina Qendrore përfshin 2 auditorë, me kapacitet përkatësisht 70 dhe 100 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative.
2. Godina e Lëndëve Paraklinike përfshin 2 auditorë leksionesh, me kapacitet 200 vende uljeje, 22 salla seminari me 30 vende uljeje, 5 laboratore me 20 vende uljeje, si dhe 31 zyra administrative.
3. Godina e Anatomisë përfshin 2 auditorë, me kapacitet 150 vende uljeje, 2 salla seminari me 30 vende uljeje, 5 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 9 zyra administrative.
4. Godina e Mjekut të Familjes përfshin 1 auditor, me kapacitet 150 vende uljeje, 2 salla seminari me 30 vende uljeje, si dhe 2 zyra administrative.
5. Godina Galileo Galilei përfshin 1 auditor, me kapacitet 150 vende uljeje, si dhe 3 zyra administrative.
6. Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik përfshin 1 auditor me kapacitet 100 vende uljeje, 5 salla seminari me 30 vende uljeje, 12 laboratorë me 20 vende uljeje, si dhe 20 zyra administrative.
7. Godina nr. 1 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 6 auditorë, me kapacitet 70 deri 200 vende uljeje, 10 salla seminari me 50 vende uljeje, 6 laboratorë me 30 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative.

8. Godina nr. 2 e Shkencave Mjekësore Teknike përfshin 4 auditorë, me kapacitet 120-150 vende uljeje, 14 salla seminari me 50 vende uljeje, 3 laboratorë me 30 vende uljeje, si dhe 21 zyra administrative.
9. Godina e Mjekësisë Dentare përfshin 2 auditorë, me kapacitet 200 vende ulje, 3 salla seminari me 30 vende uljeje, 15 laboratorë me 25 vende ulje, si dhe 14 zyra administrative.
10. Palestra sportive (shkolla “Skënder Çaçi”) është në shërbim të studentëve dhe personelit.
11. Biblioteka/salla leximi, 4 ambiente, ku mundësohet edhe aksesit në internet.

Në funksion të procesit mësimor, në kuadër të Paktit për universitetit, është hartuar projekti i detajuar i Kampusit Multifunksional për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Ky ambjent do të mundësojë sigurimin me cilësi dhe në formë të përqendruar:

- të laboratorëve të biosimulimit teknik në funksion të procesit mësimdhënës për të gjitha programet e studimit që ofron UMT-ja,
- të qendrës së zhvillimit profesional në funksion të edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetit,
- infrastrukturën e nevojshme për testimin dhe vlerësimin e informatizuar si për studentët që regjistrohen për herë të parë, ashtu dhe për pranimet e specializantëve, testimeve të pjesshme semestrale etj.
- të bibliotekës qendrore e UMT (sipas standardeve evropiane , ku përveç fondit të titujve të shërbeje dhe salle leximi),
- të sallës Aula Magna e Universitetit me kapacitete 300-350 vende ulje
- Zyra, kafeteri për studentet dhe tjerët, si dhe ambjente teknike shërbimit.

VIII. STUDENTËT

8.1 Regjistrimet në programet e studimit për vitin akademik 2018-2019

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ofron programe studimi ndër më të kërkuarat nga maturantët. Përzgjedhja e studentëve të rinj në programet e ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë është bërë mbi bazën e kriterëve të propozuara nga njësitë kryesore dhe të miratuara nga Senati Akademik i UMT-së.

Procesi i përzgjedhjes së studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruara të ciklit të dytë, kryhet dhe administrohet nga komisioni përkatës, i ngritur në nivel institucioni, me përfaqësues të fakulteteve dhe të rektoratit.

Procesin e përzgjedhjes së studentëve që aplikojnë në kuotat e veçanta apo transferim studimesh, në programet e ciklit të dytë dhe të tretë, e kanë menaxhuar vetë njësitë kryesore, ndërsa Rektorati i UMT-së ka luajtur rolin e monitoruesit.

Në varësi të ecurisë së regjistrimeve, në përputhje me kërkesat e njësive kryesore, Rektori i UMT-së ka miratuar rialokim të kuotave për programet e të njëjtit cikël studimi, duke mos tejkaluar, në asnjë rast, totalin e kapacitetit të deklaruar të kuotave, të përcaktuar në nivel njësie kryesore.

Senati i UMT-së, për vitin akademik 2018-2019, ka miratuar në total **2615** kuota, për regjistrimet e reja të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë, të integruara të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë, në përputhje me standardet e përcaktuara për raportin personel akademik me kohë të plotë për studentë dhe normativën për sipërfaqen e shfrytëzueshme për student sipas kornizës ligjore në fuqi.

Kuota të miratuara me vendim të Senatit Akademik të UMT për vitin 2018-2019 janë si vijon:


Njësia kryesore	Bsc.	M. Pr.	Msc.	PICD	SPA	Totali
Fakulteti i Mjekësisë	27	70	30	452	294	873
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	120			131	15	266
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	626	550	300			1476
TOTALI	773	620	330	583	309	2615

UMT-ja, për vitin akademik 2018-2019, ka pasur rreth **6558** studentë në programet e studimit të të gjitha cikleve. Numri total i programeve aktive që janë ofruar për të gjitha ciklet e studimit është **66** (9 Bachelor, 9 Master profesional, 7 Master i shkencave, 3 PICD, 38 SPA).


Programet e *Doktoraturës*, siç është cituar dhe në pikën 4.1, nuk janë aktivizuar në UMT prej 5 vitesh. Në përfundim të procesit të mbrojtjes së gradës shkencore “Doktor” janë **482** studentë.

Njësia kryesore	Bsc.	M. Pr.	Msc.	PICD	SPA	Totali
Fakulteti i Mjekësisë	40	74	39	2737	715	3605
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	120			608	22	750
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	1284	437	482			2203
TOTALI	1444	511	521	3345	737	6558

Përqindjet e studentëve sipas cikleve, për çdo fakultet 2018-2019



Shpërndarja se studentëve sipas cikleve, në nivel universiteti, 2018-2019



Procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të integruar të ciklit të dytë janë kryer bazuar në Udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin nr.18, datë 21.05.2018, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2018-2019”, i ndryshuar.

Procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të tretë (SPA) janë kryer duke u bazuar në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në UMT, miratuar me Vendim e Senatit Akademik të UMT-së nr. 8, datë 03.02.2020, si dhe në Udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 2, datë 03.02.2020 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2018-2019”.

8.2 Mbështetja ndaj studentëve

Në zbatim të Statutit dhe Rregullores së UMT-së, si dhe legjislacionit në fuqi, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka mundësuar dhe mbështetur studentët në nivel universiteti dhe kryesisht në nivel fakulteti. Kjo mbështetje i është dhënë si nga ana infrastrukturore dhe financiare, ashtu dhe nëpërmjet mbështetjes së pedagogëve lidhur me aktivitet shkencore, pjesëmarrje në konkurse etj.

Viti 2019, ka qenë “*viti i studentëve*”, kjo referuar një sërë aktesh normative (VKM në muajin dhjetor 2019) kryesisht lidhur me tarifat e shkollimit, ku studentët e UMT kanë përfituar maksimalisht kjo dhe për meritë të rezultateve të tyre. Informacion i detajuar gjendet te analiza financiare për vitin 2019.

IX. REFERENCA

1. Raporti vjetor mësimit, kërkimor-shkencor dhe financiar 2018, Fakulteti i Mjekësisë, UMT
2. Raporti vjetor mësimit, kërkimor-shkencor dhe financiar 2017-2018, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, UMT
3. Raporti vjetor mësimit, kërkimor-shkencor dhe financiar 2017-2018, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, UMT
4. Të dhëna statistikore të sekretarive teknike të organeve kolegjiale/drejtuese
5. Raporte informuese e analitike të komisioneve të ndryshme të ngritura gjatë vitit akademik 2017-2018, në kuadër të monitorimit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë, të ciklit të dytë dhe të integruar të ciklit të dytë, në nivel Rektorati
6. Raporte informuese e analitike të drejtorive përkatëse, Rektorati i UMT-Së, për MASR-në dhe KLSH-në
7. Të dhëna statistikore nga platforma e sistemit informatik të UMT-së (ESSE3)
8. Të dhëna nga urdhrat e profesioneve të rregulluara
9. Materiale, dokumente dhe informacione të hartuara në kuadër të aktiviteteve të ndryshme, të realizuara dhe të monitoruara në nivel universiteti etj.
10. www.umed.edu.al
11. www.fakultetimjekesise.edu.al
12. www.fmd.edu.al/
13. www.fshmt.umt.rash.al

X. ANALIZA FINANCIARE 2019

Aktiviteti ekonomik-financiar kryhet në mbështetje të veprimtarisë themelore të UMT-së, që është edukimi i studentëve në të tre ciklet e studimit, përgatitja e gjithëanshme teorike dhe praktike e profesionistëve të mjekësisë, arritje e standartave të larta në kujdesin shëndetësor si dhe stimulimi për të promovuar dhe çuar përpara kërkimin shkencor. Për realizimin e këtij aktiviteti janë të domosdoshme burimet njerëzore dhe financiare. Plotësimi i të dhënave është bërë sipas kërkesave të Udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportimin vjetor”.

Hartimi i treguesve është mbështetur në këto materiale:

- *Relacionet dhe treguesit e PBA të miratuara për vitet 2019-2020.*
- *Analizat financiare dhe ekonomike 2018 dhe 2019.*
- *Analizat ekonomiko dhe financiare të Njësive Kryesore të UMT-së (FM, FSHMT dhe FMD)*
- *Në sistemin e evidencave të plotësuara dhe të rakordura me sistemin e thesarit.*

A- Burimet njerëzore dhe struktura organizative e UMT-së.


a.1 Universiteti ushtron funksionet e tij akademike dhe administrative nëpërmjet Administratës së UMT-së dhe tre Njësive Kryesore (Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare), të cilat veprojnë si njësi ekonomiko-financiare të pavarura. Universiteti mbulon tri ciklet e studimit dhe ka 64 programe.

a.2 Sipas të dhënave në dispozicion, në 31 dhjetor 2018 nga 487 punonjës ishin në fakt 440 punonjës në rang UMT-je më pak 47 veta.


Gjatë gjithë vitit akademik, organika ka qënë e paplotësuar dhe në fund të vitit akademik 2018- 2019, kemi në fakt 435 punonjës, me një diferencë prej 52 vetash, nga të cilët 35 staf akademik, dhe 17 staf ndihmës akademik me karakter mësimor e administrativ si dhe staf administriv.

Numri total i punonjësve në mënyrë grafike paraqitet në Graf.1

Graf.2 Numri i punonjësve staf akademik.



Struktura e punonjësve në datë 30.09.2019, paraqitet në grafikun e mëposhtëm (Graf 3)



Në peshë specifike personeli akademik zë **65 %** dhe **35 %** punonjësit mbështetës. Raporti i punonjësve mbështetës me numrin e stafit akademik është 0.54, dmth për 1 punonjës staf akademik kemi aktualisht 0.54 punonjës staf mbështetës. (Referuar numrit faktik të punonjësve 30.09.2019).

B- Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor 1 vjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit.

Hartimi i treguesve PBA 2019-2021 është bërë në përputhje, me kuadrin parashikues të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, plotësimin e rekomandimeve të Raportit të Akreditimit Institucional, si dhe në funksion të përmbushjes së objektivave të përcaktuar për realizimin e politikave dhe misionit të UMT-së.

Hartimi i PBA-se 2019-2021 është ndërtuar, bazuar në ecurinë e realizimit të pritshëm të buxhetit për vitet 2018 dhe 2019, si dhe në ndryshimet e pritshme në strukturën organizative, programet e studimit, numrit të studentëve dhe në nivelin e financimit nga Buxheti i Shtetit.

Finacimi i aktivitetit të UMT-së, sipas përcaktimeve të përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë nr. 80/2015, realizohet nëpërmjet tre rrugëve.

1. Granti i mësimdhënies i detajuar për pagat dhe sigurime shoqërore, bursat e studentëve. (*Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit*)
2. Të ardhurat e kushtëzuara të institucionit (*për funksionim dhe investime*)
3. Burime të tjera të ligjshme (*donacione, projekte*).

B.1- PBA 2019-2021.

Burimet e financimit të PBA 2019-2021 paraqiten në tabelën e mëposhteme:

Nr.	EMERTIMI	I pritshmi 2018	2019	2020	2021
		000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë
1	Transferta e pakushtëzuar	550,585	941,486	635,773	616,840
2	Të ardhura të institucionit - Fonde të kushtëzuara	418,519	436,424	434,859	458,264
3	Të ardhura të institucionit - Fonde të kushtëzuara(të trashëguara)	549,949	500,212	419,814	360,455
4	Financime të huaja	26,244	26, 719	30,488	-
	TOTALI	1,545,297	1,904,841	1,520,934	1,435,559

Transferta e fondeve të pakushtëzuara paraqitet në tabelën e mëposhtme. Për vitin 2019-2021 është parashikuar dhe kërkesa për investim “Qendra e simulimit klinik” për të cilin do të paraqitet projekti dhe propozimi përkatës.

Fonde të pakushtëzuara për vitet 2019-2021					
Nr.	EMERTIMI	I pritshmi 2018	2019	2020	2021
		000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë
1	Fonde të pakushtëz, mësim dhënie	525,585	591,708	591,708	591,708
2	Fondin e mbështetjes studentore	25,000	23,998	24,565	25,132
3	Grante të tjera investime	-	325,780	19,500	0
	TOTALI	550,585	941,486	635,773	616,840

Në parashikimin e shpenzimeve të PBA-ve 2018-2020 dhe 2019-2021 është mbajtur parasysh parashikimi i saktë i nevojave për paga sigurime shoqërore për stafin akademik dhe stafin mbështetës, plotësimi sa më i mirë nevojave me bazë materiale dhe sigurimi i zhvillimit normal të aktivitetit të UMT-së.

Vendosja e prioriteteve të investimit për vitet 2019 – 2021 u orientua nga pikësynimet strategjike të bazuara tërësisht në përmbushje të Standardeve Shtetërore të Cilësisë (për “Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, por dhe me planin strategjik 2017-2019 të UMT-së.

Në fushën e investimeve është parashikuar kërkimi i fondeve grant nga buxheti i shtetit për ndërtimin e qëndrës së simulimit klinik e cila do të përdoret për formimin dhe testimin e studentëve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, por dhe si bazë e rëndësishme për ofrimin e programeve të edukimit në vazhdim. Propozimi për këtë projekt do të paraqitet për **financim buxhet për një shtrirje 3 vjeçare 2019-2021, nga granti konkures për investime**. Ndërkohë nga ana e UMT-së janë duke u kërkuar rrugë për financime të tjera për këtë projekt. Vlera e këtij

projekti është 2.4 milion euro.


Nga të ardhurat e UMT-së për vitet 2019 janë parashikuar këto investime:

- Blerje paisje elektronike për rektoratin dhe të gjitha njësitet në vlerën **13 milion 246 mijë lekë**,
- Blerje paisje moblimi për rektoratin dhe të gjitha njësitet në vlerën **7 milion 800 mijë lekë**,
- Furnizim dhe vendosje kondicionerësh për rektoratin dhe të gjitha njësitet në vlerën **13 milion 800 mijë lekë**,
- Blerje aparatura mjekësore (krijim kabinetesh për FM dhe FSHMT) në vlerën **27 milion lekë**,
- Fond libri **78 mijë lekë**.
- Studim projektim **10 milion lekë**.
- Sistem multi medial fakulteti i mjekësisë me vlerë **3 milion lekë**.
- Rikonstruksione me vlerë **2 milion e 360 mijë lekë**.

Në fushën e të ardhurave parashikimi është kryer duke pasur parasysh numrin e studentëve dhe tarifat e miratuara me Vendimin e Bordit nr.26, datë 30.05.2018, të ardhurat e parashikuara në tre vite janë në tabelen e mëposhtme:

Parashikimi i të ardhurave për vitet 2019-2021					
Nr.	NJËSIT SHPENZUESE	I pritshmi 2018	2019	2020	2021
		000/lekë	000/Lekë	000/Lekë	000/Lekë
1	Rektorati	1,100	1,100	1,100	1,100
2	Fakulteti i mjekësisë	216,198	222,317	226,665	239,700
3	Fak.Shken.Mjek.Teknike	167,212	186,087	175,159	182,389
4	Fakulteti I Mjekesise Dentare	34,009	26,920	31,935	35,075
	TOTALI	418,519	436,424	434,859	458,264

Në mënyrë grafike përdorimi i të ardhurave dhe shpenzimeve paraqitet në grafikun e mëposhtëm (graf.4):



C. Analiza e treguesve ekonomik - financiarë.

Për muajt nëntor- dhjetor 2018, shpenzimet për vitin akademik 2018-2019 përbëhen vetëm nga shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore të cilat kapin vlerën 105 milion e 092 mijë lekë. Për këto muaj shpenzimet e fondit të pagave u përballuan 87.5% nga granti i mësimdhënies dhe 12.5 % nga të ardhurat dytësore të institucionit.

Shpenzimet materiale të prokuruar në muajt e fundit të vitit ishin shumë të vogla dhe vlera e tyre rëndoi shpenzimet gjatë vitit 2019.

A. Granti i vitit 2019

Për vitin 2019, granti i mësimdhënies u financua nga buxheti i shtetit në dy faza. Në janar 2019, u financua vlera prej **492 milion e 438 mijë lekë**, e cila u detajua në:

- Paga (600) **391,599,430 lekë.**
- Sigurime shoqërore (601) **64, 818, 545 lekë.**
- Bursa (606) **36,020,000 lekë.**

Në përlogaritjen e shpërndarjes për njësitë kryesore të UMT-së u zbatua VKM nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Ky grant i akorduar nga MASR-ja në 2019, i krahasuar me grantin e akorduar e vitit 2018 ishte 7.82% më i vogël.

Në mars të vitit 2019 nga ana e MASR-së, pas ndryshimeve të kuadrit legjislativ u dërguan dhe **156 milion 834 mijë lekë**, për reduktimin e pagesës në **50%** të vlerës për studentët e ciklit të parë e të integruar, përjashtimet nga tarifa e shkollimit dhe përfitimin e bursës për studentët me notë mesatare 9-10.

Granti total i mësimdhënies arriti në vlerën **669,456,685 mijë lekë**. Shpërndarja pasqyrohet në tabelën e mëposhtme (tab.3):

EMËRTIMI I NJËSIVE SHPENZUESE	Financim i Janarit 2019	Financim Mars 2019	Total
Rektorati	34,659,912	-	34,659,912
Fakulteti i Mjekësisë	350,428,796	80,744,906	431,173,702
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	67,674,023	57,194,239	124,868,262
Fakulteti i Mjekësisë Dentare	39,675,304	18,895,024	58,570,328
TOTAL	492,438,035	156,834,169	649,272,204

Granti i mësimdhënies në total u shpenzua në masën **84%** të fondeve të akorduara.


Granti i detajuar për paga për vitin 2019 ishte në vlerën **461 milion e 794 mijë lekë**, u shpenzua në masën **90.7 %** dhe mbuloi në rang UMT-je pagat e 11 muajve. Në njësi të veçanta si FM u mbuluan pagat e 12 muajve (si rezultat i mungesave në stafin akademik dhe stafin mbështetës), në FMD 11.6 muaj etj. Në të njëjtin nivel janë dhe shpenzimet e grantit për sigurimet shoqërore.

Fondet e akorduara për bursa në formën e grantit për vitin 2019 ishin në vlerën **122,653,556 lekë**. Në përdorimin e këtij fondi u krijuan diferenca në përdorim, për arsye se numri i studentëve përfitues ishte më i vogël se fondet e akorduara. Numri i studentëve për të përfituar bursë të shqyrtuara nga komisionet e ngritura pranë çdo njësie dhe të miratuara me Vendime të Bordit të Administrimit, ishte 1.421 studentë, me efekt financiar **119,973,625**

lekë. Nga zbatimi i VKM nr.39, datë 23.01.2019 “Për një ndryshim në VKM nr. 903, datë...”, ku si kusht ishte frekuentimi i procesit të mësimdhënies, pati një kategori studentësh të cilët nuk e përfituan të plotë bursën. Gjithashtu si rezultat i ndërprerjes së procesit mësimor, nuk u pagua dhe muaji dhjetor 2018. Fondi i bursave i shpenzuar për vitin akademik 2018-2019 ishte **83,275 mijë lekë**. Diferenca prej **39 milion e 379 mijë lekë** do të trashgohet në vitin 2020.

Fondi i papërdorur në shumën **104 milion e 675 mijë lekë**, në zbatim të VKM nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor” dhe udhëzimit plotësues nr.1, datë 17.01.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2019”, do të trashëgohen për vitin 2020. **62%** e fondeve të trashëguara janë në zërin paga dhe sigurime shoqërore dhe **38%** i përkasin fondeve për bursa. (tab.4).

Në mënyra grafike përdorimi i grantit paraqitet në grafikun e mëposhtëm (graf 4).



B.2 Realizimi i të ardhurave.

Të ardhurat për vitin 2019, janë realizuar në shumë absolute **226 milion e 006 mijë lek** ose **96.06%** e të ardhurave vjetore të planifikuara në buxhetin e vitit 2019, (**4%** më shumë në krahasim me vitin 2018) (tab.5 dhe 6). Kjo shifër përfshin vlerën e tarifave me **50%** të pagesës të studimeve për ciklin e parë dhe të integruar dhe vlerën e plotë të pagesës për ciklin e dytë dhe ciklin e tretë. Realizimi i të ardhurave sipas njësive paraqitet në tabelën e mëposhtme:


Nr	EMERTIMI I NJESIVE	Viti 2019			
		PLANI	FAKTI	Dif(+),(-)	% e realizimit
		a	b	c=b-a	d=b/a*100
1	REKTORATI	1,100	1,785	685	162
2	Fakulteti i Mjekesise	132,442	113,005	(19,437)	85
3	Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike	89,016	95,364	6,348	107
4	Fakulteti i Mjekesise Dentare	12,717	15,852	3,135	125
SHUMA		235,275	226,006	(9,269)	96

Në tabelën (tab.7) bashkëlidhur materialit janë pasqyruar për çdo njësi të ardhurat e realizuar sipas ciklive të studimit të UMT-së. Të ardhurat nga mbledhja e tarifave për studentët e ciklit të parë dhe të ciklit të integruar janë realizuar në masën **105.5%** Në realizimin e të ardhurave nga këto dy cikle kanë ndikuar këta faktore:

- Numri i studentëve përsëritës të cilët ndoqën studimet për vitin akademik 2018-2019 ishte më i madh se numri i planifikuar gjatë hartimit të buxhetit të vitit 2019.
- Numri i studentëve në nevojë të përjashtuar nga tarifa e shkollimit është më i vogël se numri i parashikuar në fillim të vitit.
- Fakultetet kanë mbledhur dhe detyrime të prapambetura të tarifave të shkollimit, në vlerën **4 milion e 386 mijë lekë**.

Problematike ngelet arkëtimi i të ardhurave nga tarifat e specialistëve dhe studentët e ciklit të dytë, pagesa e të cileve kryhet me këste. Për këta studentë është mbledhur si UMT-të **59 milion e 264 mijë lekë**, me një diferencë nga plani për **23 milion 421 mijë lekë**. Numri i studentëve specialistë që kanë paguar këste të pjesshme dhe nuk kanë përmbushur detyrimin e plotë është 490 vetë.

Sipas strukturës së arkëtimeve të ardhurat paraqiten në **tab.7**, bashkëlidhur materialit dhe në mënyrë grafike në **graf.5**.



Të dy ciklet e studimit master profesional dhe shkencor, si dhe specializimet janë evidentuar si aktivitete me risk të lartë. Për këtë arsye është vlerësuar dhe organizuar puna për ndjekjen në vazhdimësi me përparësi të këtij fenomeni.

Për vitin akademik 2018-2019 u përjashtuan nga tarifa e shkollimit me notë mesatare 9-10 1.106 studentë, me një efekt financiar **23 milion e 058 mijë lekë**. Efekti financiar i kësaj shifre u mbulua me fonde të dërguara nga MASR-ë. Numri i studentëve në nevojë që plotësuan kushtet dhe kriteret bazuar në VKM-të përkatëse për vitin akademik 2018-2019 ishte 378 studentë, me një efekt financiarë **8 milion e 410 mijë lekë**. Ky efekt financiar për 378 studentë u përballua nga të ardhurta e UMT-së.

Pakësime të ardhurash pati dhe nga zbatimi i VKM nr.780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës së vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, ku përfituan përgjysmim të tarifës së studimit në masën 50%, 209 studentë të ciklit të dytë që studiojnë kryesisht në FSHMT dhe FM me një efekt financiar **10 milion e 083 mijë lekë**.

Në total nga zbatimi i VKM-ve të datës 26.12.2018, përfituan si UMT në total 1.750 studentë me një efekt finaciar prej **41 milion e 551 mijë lekë**.

Gjendja e fondeve në llogarinë e të ardhurave që trashëgojmë për vitin 2020 është **711 milion e 594 mijë lekë**. (tab.6)

Gjendja e fondeve 31.12.2019

në mijë lekë


Nr	EMËRTIMI I NJËSIVE SHPENZUESE	Viti 2019 (Fakt) Perdorimi i te ardhurave			
		Të ardhura të trashëguar a nga viti 2018	Të ardhura dytësore te realizuara	Të ardhura dytësore te përdura	Mbetje ne fund 31.12.2019
1	Rektorati	56,061	24,220	27,165	53,116
2	Fakulteti i Mjekësisë	210,158	113,005	131,489	191,674
3	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	407,878	95,364	82,096	421,146
4	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	55,766	15,852	25,960	45,658
5	TOTAL	729,863	248,441	266,710	711,594

C- Realizimi i shpenzimeve.

Shpenzimet për vitin 2019, janë realizuar në vlerën e **831 milion e 463 mijë lekë** ose **101 milion e 522 mijë lekë më shumë se viti 2018**. Krahasuar me planin vjetor të shpenzimeve të buxhetit të vitit 2019, miratuar me Vendimi i Bordit të Administrimit nr.24, datë 25.04.2019, realizimi është 59.7%. (tab.8). Krahasuar me vitin 2018 realizimi është **12% më shumë**.


Sqarojmë se, kjo vlerë i përket shpenzimeve të kryera dhe të ekzekutuara në sistemin e thesarit për periudhën janar-dhjetor, sepse siç do të sqarojmë më poshtë, këtu nuk janë të përfshira procedurat e prokurimit të përfunduara por akoma të pashlyera nëpërmjet thesarit, fondet e prokuruar me marrëveshje kuadër, procedurat e prokurimit në proces ose procedurat që janë përfunduar nënshkruar kontratat dhe pritët lëvrime i mallit sipas afateve kohore të përcaktuara në kontratë. Duke përfshirë të gjitha sa më lartë, realizimi i shpenzimeve është **68.85%**.

Referuar strukturës së burimeve financiare, 68 % e shpenzimeve janë përballuar nga granti dhe 32% nga të ardhurat dytësore. Në mënyrë grafike struktura e shpenzimeve paraqitet në grafikun e mëposhtëm (graf.6).




Po ti referohesh shumave absolute të financimit të shpenzimeve nga të ardhurat për vitin 2019, rezulton se janë përdorur 100 % të ardhurat e vitit të arkëtuara dhe të ardhurat e trashëguara janë prekur për shumën **18 milion e 269 mijë lekë**.

Për nga struktura e realizimit të shpenzimeve pesha specifike e artikujve është pasqyruar në grafikun e mëposhtëm. **(graf.7)**



Në strukturën totale të shpenzimeve të UMT-së 57% e shpenzimeve i përkasin Fakultetit të Mjekësisë, 27 % FSHMT dhe nga 8% FMD dhe Administrata e UMT-së **(graf.8)**.



E krahasuar me vitin 2018 ndryshime ka pasur në peshë specifike vetëm midis dy fakulteteve, ku FM është ulur me 2% në strukturën totale të shpenzimeve dhe FSHMT është rritur me po të njëjtën përqindje.

C.1 Artikulli 600+601. (Pagat e punonjësve dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore).

Shpenzimet e pagave janë realizuar në masën 71.2 % të shpenzimeve vjetore të planifikuara për këtë artikull në buxhetin e vitit 2019. Shpenzimet e pagave nga granti janë realizuar 90.7 % dhe nga të ardhurat 32.8%. Në shumë

absolute kjo vlerë është **200 milion e 523 mijë lekë**, ku kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm:

- Siç analizuar më lart në organikën e UMT-së janë 52 vënde vakante, efekti financiar i llogaritur është **44 milion e 724 mijë lekë**. Si rezultat i kësaj të gjitha pagat për stafin akademik dhe administrativ sipas strukturës aktuale në organikë për 11.6 muaj u përballuan nga granti dhe shuma e parashikuar nga të ardhurat për të përballuar pagat nuk u përdor (u përdor vetëm 28 milion e 350 mijë lekë).
- Në shpenzimet e pagave në planin buxhetor të miratuar të vitit 2019 ishin parashikuar edhe pagesa e udhëheqësve dhe oponentëve për procesin e mbrojtjes së doktoraturave (jo për gjithë numrin e doktoraturave, por vetëm për 350 të tilla) me një efekt të parashikuar në buxhet, në vlerë **92 milion e 400 mijë lekë**. Procedura e mbrojtjes së doktoraturave nuk u krye për vitin 2019.
- Procesi i pagesës së orëve të mbingarkesës për stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm për vitin akademik 2018-2019 nuk u realizuan plotësisht. Për këtë zë janë shpenzuar **27 milion lekë**, që i përkasin shpenzimeve të mbingarkesës mësimore të kryer nga FMD për pedagogët e brendshëm dhe diferenca të ngarkesës mësimore të papaguara për vitin akademik 2017-2018. Pagesa e mbingarkesës nuk është kryer për disa paqartësi në zbatimin e Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, për të cilën i jemi drejtuar MASR-së dhe nuk kemi akoma një përgjigje. Për mbingarkesën e orëve të mësimit në auditor fakultetet po përgatisin mbingarkesën e cila do të paguhet menjëherë me hapjen e fondeve nga MFE. Diferenca me vlerën parashikuar në buxhet është **63 milion e 399 mijë lekë**.


Në mënyrë analitike shpenzimet e pagave të ndara sipas burimeve të financimit (600/8 dhe 600/6 janë pasqyruar në pasqyrat bashkëlidhur materialit (**tab.10 dhe tab.11**).

C.2 Në të njëjtat nivele me realizimin e pagave, janë dhe shpenzimet e artikullit 601 “Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”. Diferencat me planin që janë në shumën **29 milion e 803 mijë lekë ose 70.8%** e planit


D. Artikulli 602 (shpenzime korente).

Shpenzimet e artikullit 602 janë realizuar në masën 54.08% në krahasim me shpenzimet faktike të buxhetit të miratuar 2019 dhe 72.26% duke përfshirë edhe faturat e përfunduara brenda dhjetorit që do të shlyhen në vitin 2019. Në materialin bashkëlidhur **tab.14** paraqiten të dhëna të plota për shpenzimet e llogarisë 602.

Realizimi i shpenzimeve sipas Njësive të UMT-së. (**graf.9**)



Në grafikun e mëposhtëm paraqitet pesha specifike e të gjitha nënllogarive të 602 ndaj totalit të realizmit të shpenzimeve. (graf.10)



Shpenzimet e llogarisë 602 që përballohen tërësisht nga të ardhurat e UMT-së, në vlerë absolute nga plani kanë **45 milion e 023 mijë lekë, fonde të pashfrytëzuara**. Këto fonde të analizuar sipas nënllogarive kryesore të 602 paraqitet në tabelën e mëposhtme (tab.15)

Nr. L	Emertimi i llogarit	Plan	Fakt	Fonde prokurimit	Detyrime	Fakt+ Detyrim	Diferenca	% e realizimit	Pesha specifike ndaj totalit te shpenzimeve
		a	b		c	d=b+c	e=a-d	f=e/a*100	
6020	Materiale zyre te	25,334	14,374	4,640	2,993	22,007	3,327	86.87	18.76
6021	Materiale dhe sh	25,849	15,401		3,054	18,455	7,394	71.40	15.74
6022	Sherbime nga te t	47,194	34,294		3,948	38,242	8,952	81.03	32.61
6024	Shpenzime udhet	5,977	821		30	851	5,126	14.24	0.73
6025	Mirembajtje te z	13,216	5,120		3,397	8,517	4,699	64.44	7.26
6026	Qeramarrje	2,608	1,820			1,820	788	69.79	1.55
6029	Shpenzime te tje	42,125	17,163	9,625	600	27,388	14,737	65.02	23.35
	TOTALI	162,303	88,993	14,265	14,022	117,280	45,023	72.26	100.00

Shpenzimet e artikullit 602 janë shpenzime që (përveç shpenzimeve të utiliteteve pagesat ndaj detyrimeve shtetërore tatimeve, taksat, pagesat e honorareve për organet kolegjiale, etj) lidhen me procedurat e prokurimit, realizimi i të cilave, sipas përcaktimit ligjor fillon pas miratimit të buxhetit të vitit aktual. Miratimi i buxhetit për vitin 2019 u krye në fund të muajit prill, (Vendimi i Bordit të Administrimit nr. 25, datë 25.04.2019), si rrjedhojë realizimi i Regjistrimit të Parashikimit të Prokurimit Publik është kryer në periudhën qershor-dhjetor 2019, pra për një periudhë 6 mujore.

Bazuar nësa më lart për realizimin e objektivave të parashikuara në buxhetin 2019, për shpenzimet korente (602

dhe nënlllogaritë përbërës) si dhe për investimet (230+231) dhe jo vetëm, është punuar vetëm 6 muaj për realizimin e objektivave të një viti të plotë (12 muaj). Faktor ky mjaft përcaktues në realizimin e objektivave dhe me ndikim të drejtpërdrejt në trajtimin analitik të të dhënave.

Gjatë vitit 2019, bazuar në kërkesat e njësive kryesore, miratimin e zërave respektivë në buxhetin 2019, është realizuar pajisja me materiale të nevojshme dhe reagentë për:

- a) Laboratorin e Departamentit të Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë.
- b) Laboratorin e Mikrobiologjisë, Fakulteti i Mjekësisë.
- c) Laboratorin e Departamentit të Kirurgjisë OMF, Fakulteti i Mjekësisë Dentare.
- d) Laboratorin e Departamentit të Ortopedisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare.
- e) Laboratorin e Departamentit të Terapisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare.
- f) Laboratorin Bakteriologjik, Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.

Sipas grupeve kryesore shpenzimet janë realizuar si më poshtë:

D.1 6020 “Shpenzime materiale zyre të përgjithshme”

Kjo nënlllogari e 602 është realizuar 86.87%. Këtu përfshihen shpenzimet për blerje materiale të ndryshme, kancelari, detergjente, lëndë djegëse për ngrohje, bojëra fotokopje tonera etj. Procedurat e prokurimit të parashikuara në këtë zë janë realizuar plotësisht dhe diferenca prej **3 milion e 327 mijë lekë është kursim** i krijuar gjatë procedurave të prokurimit.

D.2 6021 “Materiale dhe shërbime speciale”

Kjo nënlllogari e 602 është realizuar 71.4%. Këtu përfshihen shpenzimet për blerje materiale specifike si diploma, materiale e reagentë mjekësorë të ndryshëm, për zhvillimin e procesit mësimor akademik, libra dhe publikime profesionale etj. Në rregjistrin e parashikimit publik të vitit 2019, për këtë llogari, një pjesë e procedurave janë parashikuar të zhvillohen të përqëndruara dhe një pjesë nëpërmjet procedurave të prokurimit për blerjet e vogla nga njësitë shpenzuese të UMT-së. Nga të gjitha procedurat është realizuar një kursim në vlerën e **2 milion e 383 mijë lekë**. Shuma e fondeve të papërdorura në këtë zë është **5 milion e 011 mijë lekë** dhe vjen kryesisht nga mosrealizimi i fondeve që lidhen me punën kërkimore shkencore për botime dhe publikime profesionale dhe shkencore. Në këtë zë ishin të planifikuara dhe pagesat për akreditimin e programeve të integruara (mjekësi e përgjithshme, farmaci dhe stomatologji), pagesat e të cilave janë shlyer plotësisht.

D.3 6022 “Shërbime nga të tretët”

Kjo nënlllogari është realizuar 81.03% ndaj shpenzimeve të planifikuara. Pësia kryesore e kësaj nënlllogarie përbëhet nga shpenzimet për utilitet (drita, ujë, telefon). Në një vështrim krahasues me vitin 2017 dhe 2018, shpenzimet e likujduara për utilitet janë ulur ndjeshëm, me gjithë rritjen e numrit të kontratave pas ndarjeve të kryera nga QSUT-ja dhe klinika stomatologjike universitare. Për shpenzimet e utiliteteve në krahasim me planin janë shpenzuar më **pak 5 milion e 221 mijë lekë. (kursim)**

Në këtë nënartikull përfshihet dhe shërbimi i sigurimit dhe i ruajtjes së objekteve, i cili pas përfundimit të marrëveshjes kuadër në muajin shtator, bazuar në VKM-së nr.177, datë 04.04.2019, është lidhur kontratë me shoqërinë me kapital 100% shtetëror ILLYRIAN GUARD. Tarifat për këtë shërbim janë parashikuar në udhëzimin e përbashkët nr.407/1 datë 14.06.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Punëve të Brendshme.

Nga procedurat e prokurimit në këtë zë është realizuar një kursim në vlerën **1 milion e 911 mijë lekë**. Në këtë

nënartikull janë **1 milion e 820** mijë lekë fonde të papërdorura të cilat lidhen kryesisht me shërbimet e pastrimit dhe gjelbërimit, trajnime seminare, shërbime të tjera ngarkim shkarkimi, transporti etj. Duke përfshirë të tria vlerat e përmëndura më lart, shuma totale e kursimeve në këtë zë është **8 milion e 952 mijë lekë kursime**.

D.4 Zëri - 6024 “Shpenzime për udhëtime brenda vendit dhe jashtë vendit”.

Shpenzimet në këtë artikull janë realizuar 14.24 %, me një ndryshim nga plani në vlerën **5 milion e 126 mijë lekë**. Për kontrollin e plotë të shpenzimeve në UMT-ë është përpunuar dhe Udhëzimi i përbashkët nr.1, datë 01.08.2018 *“Për financimin e aktiviteteve për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin e delagacioneve të huaja, si dhe trajtimin e punonjësve që dërgohen me shërbim brenda dhe jashtë vendit”* i Rektorit dhe Administratorit të UMT-së. Nisur nga ky mosshfrytëzim i këtij fondi gjatë punës për hartimin e buxhetit të vitit 2020 ky zë është riparë (është ulur).

D.5 Zëri - 6025 “Mirëmbajtje të zakonshme”.

Kjo nënlllogari e 602 është realizuar 64.44 %. Këtu përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjet e ndryshme të objekteve ndërtimore, paisjeve elektronike, mobilimit, paisjet elektrike, rrjeti hidraulik etj. Gjithashtu për shkak të natyrës së shpenzimeve të këtij zëri UMT-ë dhe njësitë shpenzuese të saj parashikojnë vlera për mirëmbajtjen, të cilat shpenzohen gjatë vitit në varësi të nevojave të krijuara. Në regjistrin e parashikimit publik të vitit 2019, për këtë zë është parashikuar që një pjesë e procedurave të zhvillohen të përqëndruara dhe një pjesë nëpërmjet procedurave të prokurimit për blerjet e vogla nga njësitë shpenzuese të UMT-së. Diferenca në këtë zë është **4 milion e 699** mijë lekë dhe kryesisht janë fonde të pashpenzuara.

D.6 Zëri - 6029 “Shpenzime të tjera operative”.

Kjo nënlllogari e 602 është realizuar 65.02 %, ndaj shpenzimeve të planifikuara. Këtu përfshihen shpenzimet për pritje përcjellje, aktivitete social kulturore të personelit, organizim kongresesh, konferenca, cermoni etj, shpenzimet për honorare, shpenzimet e qeverisë studentore etj.

Në Buxhetin e miratuar për vitin 2019 është krijuar një diferencë në krahasim me planin, në zërat 6007-6009 *“Organizimi i kongreseve dhe konferencave shkencore”* të cilat janë organizuar me shpenzime minimale nga ana e njësive të UMT-së, ku nuk u përdorën **9 milion e 232 mijë lekë**, për arsye se Fakulteti i Mjekësisë shumicën e aktiviteteve i zhvilloi në sallën *“William. A. Johnson”*, në godinën e pediatriisë, dhe në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike shpenzimet ishin minimale.

Në këtë zë ishte dhe ceremonia e diplomimit e organizuar për studentët që u diplomuan në vitin akademik 2017-2018, që u organizua me të ardhurat e rektoratit në muajin shkurt 2019.

Gjithashtu dhe në zërin honorare kemi fonde të pashfrytëzuara, sepse procesi i mbrojtjes së doktoraturave është i pezulluar (për pjesën e udhëheqësve të doktoraturave nga Prof dhe Prof. Asc. në pension). **Diferenca në këtë zë është 1 milion e 823 mijë lekë.**

Analiza më e detajuar e diferencës për **45 milion e 023 mijë lekë** paraqitet në tabelën e mëposhtme. (tab.16)

Nr	Emertimi	Diferenca e 602			
		Kursim nga procedurat e prokurimit	Kursim nga fondet e utilite te ve	Fonde te paperdorur .	TOTAL
6020	Materiale zyre te pergjithshme	3,327		0	3,327
6021	Materiale dhe sherbime speciale	2,383		5011	7,394
6022	Sherbime nga te trete	1,911	5,221	1,820	8,952
6024	Shpenz udhetimi brenda e Jashte Vendit			5,126	5,126
6025	Mirembajtje te zakonshme			4,699	4,699
6026	Qeramarrje			788	788
6029	Shpenzime te tjera operative	1,158		13,579	14,737
	Totali	8,779	5,221	31,023	45,023

Të dhënat e krahasuara me realizimin e shpenzimeve me vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 paraqiten në tabelën e mëposhtme (tab.17)

Nr	Emertimi	Realizimi i llogarise 602 ne vite				
		2015	2016	2017	2018	2019
1	Administrata e Rektoratit	16,961	30,045	17,132	15,653	25,263
2	FM	25,523	36,899	31,584	59,598	60,017
3	FSHMT	23,403	19,787	17,385	22,353	28,158
4	FMD	2,687	3,695	2,959	8,278	6,015
	Total	68,574	90,426	69,060	105,882	119,453

Realizimi i shpenzimeve të llogarisë 602 në vitin 2019, është në nivelin më të lartë të pesë viteve, duke pasur parasysh dhe uljen e nivelit të shpenzimeve të utilitetëve. Kjo do të thotë që janë plotësuar më mire kërkesat për mallra, materiale, reagent edhe për procedura të parealizuar vite më parë, me qëllim plotësimin e nevojave për zhvillim normal të procesit mësimor akademik dhe përmirësimin e kushteve dhe mirëmbajtjen e ambienteve. Siç theksuam edhe më lartë të gjitha procedurat e prokurimit të përqëndruara të planifikuara për vitin 2019 u realizuan, nga të cilat rezultoi vetëm një procedurë e anuluar (shërbimi i mirëmbajtjes së kondicionerëve).

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet realizimi i shpenzimeve “Mallra dhe shërbime të tjera në vite”



E. 230+231 Investime

Burimi i financimit të investimeve dhe të planifikuara në buxhetit janë ardhurat e UMT-së.

Të dhënat për realizimin e investimeve paraqiten në tabelën e mëposhtme. (tab.21)

NR	NJESITE	Plan	Fakt	Procedura te perfunduara ose proces	Fakt+Dety rime	Diferenc a	Perqin e fakt ndaj planit	Perqindja fakt/Detyr ndaj planit
1	Admi. e UMT-se	35,305	2,477	5,320	7,797	27,508	22.08	22.08
2	FM	164,233	49,173	59,066	108,239	55,994	29.94	65.91
3	FSHMT	57,663	1,191	33,999	35,190	22,473	2.07	61.03
4	FMD	24,435	14,210	-	14,210	10,225	58.15	58.15
5	TOTALI	281,636	67,051	98,385	165,436	116,200	23.81	58.74

Investimet e përfunduara konsistojnë në fushën e krijimit të laboratoreve dhe kabineteve të reja, paisjen e laboratorëve ekzistues me aparatura të reja, paisje elektronike, mobilim e sallave të leksioneve kabineteve etj.

Sipas kërkesave të njësive kryesore, janë kryer procedurat për blerje pajisjeje laboratorësh. Konkretisht:

a) Për Fakultetin e Mjekësisë ka përfunduar procedura e prokurimit dhe është në fazën e lidhjes së kontratës për pajisjet e laboratoreve të sëmundjeve klinike dhe imazherisë, morfologjisë, laboratorët, farmaci dhe nuroshkencës). Nga procedurat e prokurimit u kursyen **5 milion 601 mijë leke**.

b) Për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike ka përfunduar procedura e prokurimit për 3 loteve për krijimin e kabineteve mësimore. Nga procedurat e prokurimit u kursyen **1 milion 545 mijë leke**.

Loti 1 “Blerje pajisje kompjuterike”

Loti 2: “Blerje pajisje mjekësore, laboratorike dhe Manekine”

Loti 3: “Mobilje spitalore”

c) Për Fakultetin e Mjekësisë ka përfunduar tenderi “Rikonstruksion i paraklinikut dhe bodrumeve të dekanatit të FM-së”. Nga procedurat e prokurimit u kursyen **4 milion 332 mijë leke**.

d) Për Fakultetin e Mjekësisë ka përfunduar tenderi “Sistemi multimedial audiovizual i centralizuar”. Nga procedurat e prokurimit u kursyen **13 mijë leke**.

e) Blerje pajisjesh kompjuterike për gjithë UMT-në. Nga procedurat e prokurimit u kursyen **1 milion 956 mijë leke**.

f) Nga ana e njësive janë kryer edhe disa procedura prokurimi për rregullimin dhe përshtatjen e ambienteve të parashikuar në buxhetin e vitit 2019.

Fondet e papërdorura të investimeve janë në shumën 116 milion e 119 mijë lekë. Faktorët që kanë ndikuar janë analizuar më poshtë:

- Për procedurat e zhvilluara është realizuar një kursim në vlerën **13 milion e 776 mijë lekë** nga fondi limit i publikuar.
- 3 procedura me vlerë, **14 milion e 693 mijë lekë**, u anuluan gjatë procesit të prokurimit, sipas shkaqeve të analizuar më poshtë:

1. **Blerje aparatura stomatologjike FMD**, anuluar në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika “ç”, sepse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhej me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. 2 lote në krijim kabinetesh në FSHMT, anuluar në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika “ç”, sepse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhej me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. **Instalim dhe furnizim kondicionerësh**, anuluar në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24, pika “ç”, sepse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhej me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

-Për investimet e mëposhtme nuk u arrit të realizohej fillimi i procedurave. Vlera e këtyre procedurave është **87 milion e 811 mijë lekë me tvsh**. Më poshtë janë investimet kryesore për të cilat nuk u arrit fillimi i procedurave.

- Studim projektim për rikonstrukcionin e UMT, me fond limit 8 milion e 330 mijë lekë me tvsh për mungesë stafi të specializuar.
- Blerje paisjesh kundra zjarrit dhe vendosja e shkallës së emergjencës, me fond limit 10 milion e 400 mije lekë me tvsh, pasi nuk u arrit llogaritja e fondit limit (studim projektimi) për hapjen e procedurës së prokurimit.
- Rikonstrukcion i sallës së këshillit të profesorëve, dhe rikonstrukcion i sallës blu për të cilat pas mosmarrjes përsipër nga Ministria e Shëndetësisë, u hartua vetëm projekti, ky investim është shtyrë për vitin 2020.
- Blerje paisje mobilimi për sallat e leksioneve dhe kabineteve, investim i cili është shtyrë për vitin 2020.

Duhet theksuar se në investime janë parashikuar dhe fondet për projektet kërkimore shkencore të cilat nuk janë realizuar për mungesë projektesh në vlerën e **10 milion lekëve**.

Gjithashtu bazuar në marrëveshjen e lidhur midis UMT-së dhe RASH-it për ngritjen e sistemit të shërbimeve për studentët, ashtu si dhe në PBA 2019-2021 është parashikuar një fond prej **5 milion lekë**, shifër kjo që u la e padetajuar në pjesën e investimeve të njësisë qendrore të UMT-së, e cila do të detajohej në varësi të shpenzimeve dhe shërbimeve që do të kryheshin. Për momentin nuk ka asnjë projekt dhe ky fond në shumën 5 milion lekë nuk u përdor.

Analiza më e detajuar e diferencës për **81 milion e 147 mijë lekë**, paraqitet në tabelën e mëposhtme (tab.23):

Nr	Diferenca e Investimeve	Vlera
1	Kursim nga procedurat e prokurimit procedurat e pro	13,776,285
2	Procedura te anuluar	14,611,693
3	Procedura te pazhvilluara	87,811,930
	TOTALI	116,199,908


Në analizë krahasuese me nivelin e investimeve të realizuar ne vitet 2015-2016-2017-2018, kemi të dhënat e

mëposhtme (Tab.22):

NR	EMËRTIMI	REALIZIMI I INVESTIMEVE NË VITE					
		2015	2016	2017	2018	Total	2019
1	Administrata e Rekt	2,843	2,878	6,281	6,020	18,022	7,797
2	FM	-	4,935	15,513	44,469	64,917	108,239
3	FSHMT	6,749	9,023	10,992	2,192	28,956	35,190
4	FMD	6,728	556	4,289	19,998	31,571	14,210
	TOTAL	16,320	17,392	37,074	72,679	143,465	165,436

Si UMT-ë në vitin 2019 janë realizuar **21 milion 971 mijë lekë** me shumë investime se të katër vitet së bashku. Në krahasim me vitin 2018 janë realizuar **15.3%** investime më shumë.


Në mënyrë grafike realizimi i investimeve për vitet 2015-2019 paraqitet në grafikun e mëposhtëm.



F- Në përfundim të analizës së shpenzimeve për çdo artikull, shuma e fondeve të papërdoura është 456 milion e 739 mijë lekë. Arësyet e mospërdorimit janë trajtuar gjatë analizës së grupeve të veçanta të shpenzimeve. Në këtë fond të papërdorur për 2019, fondet për shpenzimet e pagave, sigurimeve shoqërore dhe bursave zënë peshën specifike më të madhe. Pesa specifike e të treja këtyre shpenzimeve zë 59% të fondeve të papërdorura. Fondet e investimeve zënë 25.4%, mallra materiale 9.9%. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen fondet e papërdorura sipas natyrës së shpenzimeve.(tab.9)

Nr.	EMERTIMI	Totali i Fondeve			
		diferenca sipas thesarit	fonde te prokuruar dhe detyrime	Fonde te pashfrytezuara 2019	Në %
1	Paga, art. (600)	200,523		200,523	43.9
2	Sigurimet shoq. dhe shendets. art.(601)	29,803		29,803	6.5
3	Shpenzime operative, art. (602)	73,311	28,287	45,024	9.9
4	Shpenzime transfertë te brendshme 604	23,865		23,865	5.2
5	Shpenzime transfertë te brendshme, art. (60)	2,044		2,044	0.4
6	Bursa per studentet, art. (606)	39,279		39,279	8.6
7	Investime, art. (230)	-		-	0.0
8	Investime , art. (231)	214,586	98,385	116,201	25.4
9	Investime nga buxheti (I pritshem) art. (231)	-		-	
	TOTALI	583,411	126,672	456,739	100.0

Sipas përqindjeve pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:



G-Në buxhetin e vitit 2019 ishin planifikuar sipas kërkesave nga njësitë shpenzuese por dhe sipas orientimeve të Bordit të Administrimit fonde për punën kërkimore shkencore. Realizimi i fondeve është minimal për fondet të planifikuara në llogarinë mallra material dhe për fondet e planifikuara në llogarinë e studimeve dhe investimeve nuk kishte asnjë projekt për vitin 2019. Të dhënat për keto fonde pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

NR	NJESITE	Mallra materiale 602			Investime 230+231		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
2	FM	2,079	710	34	5,000	-	
3	FSHMT	6,954	1,044	15	3,000	-	
4	FMD	720	194	27	2,000	-	
5	TOTALI	9,753	1,948	20	10,000	-	

GJ- Pranë AKKSH-it në përgjigje të thirrjes datë 07.06.2019 për projekte infrastrukturore në kuadër të “Paktit për Universitetin”, Universiteti i Mjekësisë fitoi dy projekte:

1. Projekti “Aplikimi i teknologjisë digjitale në stomatologji”, me drejtuese projekti Prof.Asc. Merita Bardhoshi, me vlerë 5,400,000 lekë.
2. Projekti “Aplikimi i imunocitometrisë me fluks në studimin e funksionit fagocitar dhe limfocitar si dhe në imunofenotipizimin qelizor të nyjeve limfatike” me drejtues projekti Prof. Genc Sulçebe, me vlerë 7,300,000 lekë.

Me gjithë kohën e kufizuar, sepse fondet e projekteve u lëvruan në muajin Tetor 2019, u përgatitën dhe u kryen procedurat e prokurimit për të dy projektet. Në procedurën e prokurimit për blerjen e aparaturave të projektit “Aplikimi i teknologjisë digjitale në stomatologji”, nuk rezultoi asnjë operator fitues dhe si pasojë u anulua.

Për projektin “*Aplikimi i imunocitometrisë me fluks në studimin e funksionit fagocitar dhe limfocitar si dhe në imunofenotipizimin qelizor të nyjeve limfatike*” u kryen procedurat e prokurimit dhe është lidhur kontrata, por jemi në pritje të rialokimit të fondeve për vitin 2020, nga AKKSHI.

Gjithashtu pranë AKKSH-it është fituar dhe projekti “*Identifikimi i teknikës optimale intraoperatore të kardiomioplastikës qelizore në mënyrë simultante me rickularizimin kirurgjikal tek zemrat humane të infraktuara nëpërmjet implantimit të qelizave staminale autologa në rrugë të ndryshme*”, me drejtues projekti Prof. Edvin Prifti, por për shkak të disa mangësive proceduriale të AKKSHI-së në çeljen e fondeve, ky projekt nuk ka filluar nga implementimi.